



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOĖ NARODA



**KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE**



FONDACIONE KOSOVAR PER SHODERI CIVILE  
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

# **RAPORTI I MONITORIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL LOKAL PËR VITIN 2023**

PRISHTINË, 2024



**Ky raport është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.**

**Raporti është realizuar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me USAID në Kosovë. KLGJ është partner i KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.**



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE**



# **RAPORTI I MONITORIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL LOKAL PËR VITIN 2023**

## Përmbajtja

.....	1
Hyrje.....	5
Metodologjia.....	7
Monitorimi Vjetor .....	10
Aspekti administrativ dhe teknik .....	10
Rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronike .....	11
Planifikimi i konsultimeve publike .....	11
Përgatitja e planeve .....	12
Konsultimi në fazat e hershme .....	12
Shpallja e thirrjes për identifikim dhe përfshije të palëve të interesuara në grupet punuese.....	13
Propozimet nga grupet e jashtme punuese, iniciativat apo komitetet konsultative .....	13
Raportimi, bashkëpunimi dhe monitorimi.....	14
Procesi i raportimit dhe monitorimit .....	14
Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi .....	14
Tabelat vjetore të vlerësimit të performancës së konsultimeve publike .....	15
Monitorimi Individual .....	22
Konsultimet për Dëgjime Buxhetore .....	23
Shpallja publike për konsultim publik.....	23
Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike .....	24
Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre .....	25
Konsultimet Publike për Rregulloret Komunale .....	26
Shpallja publike për konsultim publik.....	26
Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike .....	27
Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre .....	28
Konsultim Publik për Planin Komunal.....	29
Shpallja Publike për Konsultim Publik.....	29
Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike .....	30
Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre .....	31
Tabelat e vlerësimeve individuale të performancës së konsultimeve.....	32
Te gjeturat nga raportet relevante të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .....	37
Konkluzione dhe Rekomandime .....	40

## Hyrje

Raporti i Monitorimit të Konsultimit Publik në Nivelin Lokal për vitin 2023, ka për qëllim të pasqyrojë përmbushjen e obligimeve të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Në nivelin komunal, proceset konsultative mbeten të paqarta e me angazhim të kufizuar të qytetarëve. Kjo, si rrjedhojë e një procesi të papërgatitur mirë, si dhe një zbatimi kryesisht formal nga ana e institucioneve komunale. Ajo që mbetet më sfiduese është ndër-veprimi mes komunave dhe qytetarëve. Në mungesë të një qasje të vazhdueshme të informimit dhe komunikimit nga komunat, qytetarët nuk po arrijnë të ndjekin se si çështjet e tyre po adresohen në politikat dhe financimet komunale. Në këtë mes edhe roli i shoqërisë civile dhe profesionistëve, mbetet i pa përfshirë në kontributin për politikat komunale.

Procesi i monitorimit përdor një qasje dy kahore të intervenimit: në njërën anë, vlerëson nivelin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivelin lokal, e në anën tjetër, ofron informacione, nëpërmjet të dhënave, konkluzioneve dhe rekomandimeve si mjete për përmirësim. Institucionet komunale si bartëse të procesit, nëpërmjet monitorimit kanë të identifikuar fushat ku ka mangësi dhe ato me progres. Kjo ndihmon ato në përmirësim nisur nga planifikimi, zbatimi i procesit, monitorimi dhe raportimi. Ndërkaq, organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal dhe aktivistët, nëpërmjet përfshirjes direkte në monitorim, marrin informacione për procesin, njihen me problemet dhe arrijnë si dhe nxjerrin fusha/çështje ku duhet mbajtur përgjegjës komunat. Monitorimi i zbatimit të standardeve të konsultimeve publike, në ndikim afatgjatë, synon sigurimin e informacionit, rritjes së komunikimit mes palëve, edukimin e organizatave dhe komunitetit për të mbajtur të angazhuara dhe llogaridhënëse komunat karshi qytetarëve.

Monitorimi i proceseve vjetore pasqyron pamjen e plotë mbi përgatitjet për zbatimin e procesit, duke u ofruar palëve një hartëzim për hallkat e dobëta të procesit dhe mundësi për raportime të përmbledhura. Mund të shërbejë për të adresuar në veçanti tri elemente: i. Nivelin e përgatitjes teknike dhe procedurale për procesin e konsultimit publik; ii. Nivelin e zbatimit të konsultimit publik, duke përfshirë edhe indikatorë cilësorë; si dhe iii. Pasqyrimin e nevojave për intervenim në hallka të veçanta të procesit.

Në procesin e monitorimit vjetor, janë vlerësuar niveli i përgatitjes në 34 komuna<sup>1</sup>, lidhur me zbatimin e konsultimeve publike, përfshirë planifikimet, caktimin e zyrtarëve përgjegjës për konsultime, përgatitjen e formularëve shpjegues, konsultimet në fazat e hershme, përfshirjen OJQ-ve dhe profesionistëve në grupet punuese, nismat apo projekt propozimet nga grupet e jashtme, monitorimi dhe raportimet. Për të konfirmuar të dhënat, janë kërkuar informacione në 34 komuna, ndërkaq nëpërmjet qasjes në dokumente publike<sup>2</sup> janë marrë përgjigje nga 16 Zyra për Informim në Komuna.

Nga raportet e monitorimit vjetor del se nga 34 komuna, mesatarisht 52% e tyre kanë plotësuar aspektet administrative dhe teknike të procesit të konsultimit publik, mesatarisht 44% kanë planifikuar proceset e konsultimeve publike dhe mesatarisht 41% kanë hartuar raportet e konsultimeve publike.

---

<sup>1</sup> Komunat në veri të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok), nuk kanë të dhëna në ueb faqe dhe nuk raportojnë në raportet e referuara të monitorimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

<sup>2</sup> Monitoruesit kanë dërguar pyetje, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, referuar nenit 12 afatet për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>.

Ndërkaq, nga përgjigjet e 16 Zyrave për Informim në Komuna, janë raportuar se 6% e tyre kanë zhvilluar konsultime në faza të hershme, asnjë komunë ose 0% nuk kanë pranuar propozime nga grupet e jashtme, si dhe 6% kanë raportuar se projekt propozimet janë refuzuar të shkojnë në miratim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA)<sup>3</sup> apo refuzohen nga Kuvendi Komunal dokumentet që nuk kanë përmbushur standardet e konsultimit. Po ashtu, 6% e komunave kanë raportuar vendime për përfshirjen e palëve të interesuara në grupet punuese, 31.25% e komunave kanë krijuar bazë të të dhënave për grupet e interesit, dhe asnjë rast nuk është raportuar për shpalljen e thirrjeve për identifikimin e palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese.

Përderisa, udhëzimi administrativ kërkon nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të hartojë raport për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik në Komuna dhe atë ta dërgojë te Zyra për Qeverisje të Mirë, të dhënat për komunat nuk gjenden në raportet vjetore në platformën e konsultimeve publike<sup>4</sup>. Megjithatë, disa të dhëna mbi konsultimet publike, mund të gjenden në Raportin për Vlerësimin e Transparencës në Komuna (janar-dhjetor 2022) dhe raportet tjera relevante.

Të dhënat e raportimeve vjetore janë krahasuar me raportet periodike të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Raporti për Përmbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane, janar-qershor 2023, Raporti i Vlerësimit të Transparencës në Komuna, janar-dhjetor 2022 dhe Raporti i Monitorimit të Funkcionimit të Kuvendeve Komunale (janar-dhjetor 2022). Këto raporte shërbejnë për të ndjekur nivelin e progresit, në veçanti atë të përgatitjes së konsultimeve publike mes vitit 2022 dhe 2023, si: caktimi i zyrtarit për konsultim, planet e konsultimeve, funksionimi i ueb faqeve komunale, strategjitë për komunikim me publikun, publikimi i raporteve të konsultimeve si dhe Komitetet Konsultative të themeluara.

Ndërkaq, në proceset e monitorimeve individuale të konsultimeve janë përfshirë 34 komuna me nga tri kategori (dëgjime buxhetore; plane/strategji komunale dhe akte/rregullore komunale), nga një proces të konsultimit ku ofrohet një pasqyrim gjithëpërfshirës se si po zbatohen konsultimet publike në komuna. Kjo, duke vlerësuar tri nivele të zbatimit: i. Shpalljen e thirrjeve; ii. Zhvillimin e takimeve publike; iii. Mbledhjen e komenteve dhe adresimin e tyre.

Sipas fushave, te proceset buxhetore del se, shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, ka arritur përmbushje me një mesatare prej 78%. Zhvillimi i proceseve të konsultimit ka arritur 73%; ndërkaq, mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre merr një mesatare prej 51%. Tek aktet/rregulloret del se, shpallja e publike për konsultime ka arritur 64%, zhvillimi i proceseve të konsultimit 66%, dhe përmbushja më e ulët del të jetë tek mbledhja e komenteve duke arritur një mesatare prej 36%. Ndërkaq, te planet/strategjitë komunale del se, shpallja e publike për konsultime ka arritur 74%, zhvillimi i proceseve të konsultimit 76%, dhe mbledhja e komenteve 32%.

Të dhënat nga raportet e monitorimit individual tregojnë se:

- te shpallja publike, në më së shumti raste është paraqitur data e nisjes së konsultimit me 88%, ndërkaq në më së paku raste është paraqitur memorandum i shpjegues me 22%,

---

<sup>3</sup> Në kuptimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në rastin e Komunës është Kryetari i Komunës

<sup>4</sup> <https://konsultimet.rks-gov.net/documents.php>

- te zhvillimi i proceseve të konsultimit më së shumti raste është bërë paraqitja e vendit të mbajtjes së takimit me 95%, dhe më së paku raste, është bashkangjitur memorandumit shpjegues me 22%.

- te mbledhja dhe adresimi i komenteve, më së shumti raste shënon përgatitja e raportit me 54%, ndërkaq më së paku raste shënon paraqitja e raportit të konsultimit tek kuvendi i komunës me 18%.

## Metodologjia

Referuar Udhëzimit Administrativ 06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna<sup>5</sup>, procesi i monitorimit është shtrirë në dy rrafshje: i. Monitorimi vjetor (procesi i përgjithshëm i konsultimeve publike), dhe ii. Monitorimet e proceseve individuale (tri konsultime publike të përzgjedhura).

### Monitorimi Vjetor:

Te kjo kategori, janë vendosur indikatorë matës<sup>6</sup> të nxjerrë nga metodologjia për konsultime publike edhe sipas përgjegjësive të mekanizmave komunalë me përlllogaritje një pikë për secilin obligim. Për të vlerësuar përmbushjen e obligimeve nga komunat për procesin e konsultimit publik, në monitorimin vjetor janë nxjerrë të dhëna për këto kategori: planifikimi i konsultimeve; përmbushja e detyrave administrative; ueb faqja dhe e-konsultimi; monitorimi i zbatimit dhe hartimi i raportit vjetor nga Ministria përgjegjëse.

Procesi i monitorimit vjetor është shtrirë në tre hapa:

- Hapi 1. Monitorimi i të dhënave nëpërmjet ueb faqeve të komunave;
- Hapi 2. Intervista/pyetjet për Zyrat për Informim në Komuna;
- Hapi 3. Plotësimi i formularëve me indikatorë sipas përgjegjësive të mekanizmave komunalë.

### Monitorimi Individual:

Referuar nenit 6 (dokumentet për konsultim publik<sup>7</sup>) dhe nenit 7 (Aktet nënligjore të komunës për konsultim publik)<sup>8</sup> të Udhëzimit Administrativ 06/2008 janë monitoruar tri kategori të dokumenteve në proceset e konsultimit: i. dokumentet vjetore<sup>9</sup> (kornizat afatmesme të buxhetit, buxheti i vitit përkatës, planet vjetore të punës), ii. dokumentet strategjike<sup>10</sup>; si dhe iii. aktet komunale<sup>11</sup> (statuti i komunës, rregulloret dhe aktet e parapara me ligjet sektoriale).

Për këtë, monitoruesit kanë përzgjedhur nga një proces nga secila kategori: dokumentet vjetore; planet dhe dokumentet strategjike si dhe aktet komunale.

---

<sup>5</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

<sup>6</sup> <https://www.klgi-ks.com/wp-content/uploads/2023/05/Metodologjia-e-Monitorimit-te-Konsultimit-Publik-ne-Komuna.pdf>

<sup>7</sup> Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të komunës dhe kryetarit të Komunës / ekzekutivit; Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor; Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme; Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimt në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale; Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor; Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik; Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

<sup>8</sup> Neni 7 Aktet nënligjore të komunës për konsultim publik 1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë: 1.1 Draft-Statuti i Komunës; 1.2 Projekt-rregulloret Komunale; 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

<sup>9</sup> Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të komunës dhe kryetarit të Komunës / ekzekutivit; 1.2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor; 1.3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;

<sup>10</sup> Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të komunës dhe kryetarit të Komunës / ekzekutivit; 1.2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor; 1.3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;

<sup>11</sup> 1.1 Draft-Statuti i Komunës; 1.2 Projekt-rregulloret Komunale; 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

Procesi i monitorimit është shtrirë në katër hapa:

- Hapi 1: Përzgjedhja e tri proceseve të monitorimit;
- Hapi 2: Gjetja e të dhënave në ueb faqet e komunave dhe platformën e konsultimeve;
- Hapi 3: Monitorimi i Zbatimit të Procesit (monitorimi individual);
- Hapi 4: Verifikimi i të dhënave (linçet në tabelat e monitorimit).

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) me ndihmën e OJQ-ve lokale të cilat janë përzgjedhur përmes thirrjes së hapur për angazhim dhe katër aktivistë kanë monitoruar 34 komuna.

Bashkëpunëtorët e përfshirë janë:

- Rrjeti i OJQ-ve Lokale Demokracia Fillon Këtu (rrjeti DFK) që ka monitoruar komunat: Podujevë, Obiliq, Mitrovicë e Jugut, Junik, Rahovec dhe Deçan;
- Organizata për Hulumtime Ekonomike dhe Sociale OHES që ka monitoruar komunat: Malishevë, Suharekë, Dragash;
- Fisnik Egër, pjesëmarrës në Akademinë për Udhëheqësi në Komunitet, organizuar nga CEA ka monitoruar komunat: Prizren dhe Mamushë;
- Jehona Osmani, pjesëmarrëse në Akademinë për Udhëheqësi në Komunitet, organizuar nga CEA ka monitoruar komunën: Gjakovë;
- Miranda Karpuzi, pjesëmarrëse në Akademinë për Udhëheqësi në Komunitet, organizuar nga CEA ka monitoruar komunat: Shtime, Hani i Elezit;
- NGO New Millennium ka monitoruar komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë;
- Vullnetaret e Qytetit ka monitoruar komunat: Kamenicë, Gjilan, Ranillug, Novobërdë;
- Center for Education and Community Development - friends (CECD - friends), ka monitoruar komunat: Vushtrri dhe Skenderaj;
- Instituti për Integritet Publik, ka monitoruar komunat: Glogoc, Lipjan
- Organizata ZANA, ka monitoruar komunat: Klinë, Istog;
- Rrjeti i OJQ-ve AVONET, ka monitoruar komunën: Ferizaj, Shtërpçë, Kaçanik;
- Organizata Lions International-Lions Club Peja, ka monitoruar komunën: Peja;
- Organizata Politeia ka monitoruar komunat: Viti, Partesh, Klllokot, Graçanicë;
- Gentrin Krasniqi: observues i procesit të monitorimit, pjesëmarrës në Akademinë për Udhëheqësi në Komunitet organizuar nga CEA.

Për të siguruar shtrirje horizontale (pamja e plotë e komunave) dhe për të arritur në krahasime lidhur me zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik, si dhe siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, monitoruesit, kanë përzgjedhur tri kategori të konsultimeve publike:

1. Dëgjimet/konsultimet buxhetore;
2. Hartimin e rregullativës/akteve komunale; dhe
3. Hartimin planeve/strategjie komunale.

Procesi i monitorimit përfshinë: raportin e proceseve të dëgjimeve buxhetore; një rregullore apo akt komunal dhe një plan apo strategji komunale e zhvilluar brenda vitit të monitorimit.



Për të vlerësuar në tërësi procesin e konsultimit publik janë kryer dy forma të monitorimit (individual dhe vjetor):

- Në procesin e monitorimit individual nga (dokumentet veç e veç) nxjerrën të dhënat për nivelin e zbatimit të procesit të konsultimit, sipas fushave;
- Në procesin e monitorimit vjetor (i tërë procesi), vlerësohet niveli i përmbushjes sa i përket aspekteve administrative, planifikimit, monitorimit/raportimit dhe koordinimit/bashkëpunimit.

#### **Hapat e Procesit:**

- Hapi I – Mbledhja e të dhënave/vlerësimet individuale (Plani i konsultimeve publike; Thirrjet publike, Publikimi në platformën qeveritare të konsultimeve publike; Raporti me komentet e procesit të konsultimit publik; Raporti i Bashkëngjitur në Materialet e Punës së Kuvendit Komunal);
- Hapi II – Kërkimi i të dhënave të konsultimit publik; kërkimi në ueb faqe, në kategorinë e njoftimeve/shpalljeve të komunës, në rast se kjo e dhënë nuk gjendet, kërkimi në rrjete sociale (faqja zyrtare në Facebook);
- Hapi III - Konfirmimi i të dhënave: Në rast se të dhënat nuk janë gjetur në ueb faqe, konfirmimi nga zyra për informim - numri i proceseve të konsultimeve, publikimi i thirrjeve publike, mbajtja e takimeve me publikun, përdorimi i formave tjera të konsultimit, raportet e konsultimit në materialet e punës së Kuvendeve Komunale;
- Hapi IV – Nxjerrja e pyetjeve për Zyrat për Informim të Komunave - pyetjet për procesin e konsultimit publik; caktimi i afatit të kthimit të përgjigjes shtatë (7) ditë;<sup>12</sup>
- Hapi V – Grumbullimi dhe segmentimi i të dhënave sipas indikatorëve specifikë dhe të grupuar;
- Hapi VI – Verifikimi i të dhënave; gjatë vendosjes në tabelat përmbledhëse për dhjetë ditë (10) janë verifikuar të dhënat nga stafi i KLGJ-së;
- Hapi VII – Observimi; një (1) observues ka marrë të dhënat nga kërkesat e Zyrave për Informim në Komuna dhe kanë krahasuar numrin e proceseve të planifikuara dhe ato të zbatuara, duke nxjerrë informacione krahasuese mbi ndryshimet si dhe ofruar pasqyrimin e gjerë të procesit;
- Hapi VIII – Analizimi i të dhënave dhe hartimi i raportit; të dhënat sipas indikatorëve si dhe të grupuara në kritere janë analizuar si dhe interpretuar, pas kësaj të dhënat janë ndërthurur dhe krahasuar me raportet e monitorimit periodik nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për të nxjerrë progresin si dhe parë sfidat e përgjithshme.

---

<sup>12</sup> Neni 12 - Afatet për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, pika 3;

## Monitorimi Vjetor

Në procesin e monitorimit vjetor është vlerësuar niveli i përgatitjes në 34 komuna lidhur me zbatimin e konsultimeve publike përfshirë, planifikimet, caktimin e zyrtarëve përgjegjës për konsultime, përgatitjen e formularëve shpjegues, konsultimet në fazat e hershme, përfshirjen OJQ-ve dhe profesionistëve në grupet punuese, nismat apo projekt propozimet nga grupet e jashtme, monitorimi dhe raportimet. Për të konfirmuar të dhënat, janë kërkuar informacione në 34 komuna, ndërkaq nëpërmjet qasjes në dokumente publike janë marrë përgjigje nga 16 Zyra për Informim në Komuna.

Nga raportet e monitorimit vjetor del se nga 34 komuna, mesatarisht 52% e tyre kanë plotësuar aspektet administrative dhe teknike të procesit të konsultimit publik, mesatarisht 44% kanë planifikuar proceset e konsultimeve publike dhe mesatarisht 41% kanë raportuar mbi zbatimin e konsultimit publik.

Ndërkaq, nga përgjigjet e 16 Zyrave për Informim në Komuna janë raportuar se 6% e tyre kanë zhvilluar konsultime në faza të hershme, asnjë komunë ose 0% nuk kanë pranuar propozime nga grupet e jashtme, ndërsa 6% e tyre kanë raportuar se projekt propozimet janë refuzuar të shkojnë në miratim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) apo Kuvendi Komunal refuzohen dokumentet që nuk kanë përmbushur standardet e konsultimit dhe 6% kanë raportuar vendime për përfshirjen e palëve të interesuara në grupet punuese, në 31.25% kanë krijuar bazë të të dhënave për grupet e interesit dhe asnjë rast nuk është raportuar për shpalljen e thirrjeve për identifikimin të palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese.

Përderisa udhëzimi administrativ kërkon nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të hartojë raport për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik në Komuna dhe atë ta dërgojë te Zyra për Qeverisje të Mirë, të dhënat për komunat nuk gjenden në raportet vjetore në platformën e konsultimeve publike. Megjithatë, disa të dhëna gjenden në raportin për vlerësimin e transparencës në Komuna (janar-dhjetor 2022) dhe raportet tjera relevante.

### Aspekti administrativ dhe teknik

Lidhur me vlerësimin e aspektit administrativ dhe teknik janë nxjerrë të dhëna për dy fusha: në fushën e parë, përfshihen përgatitjet për procesin si: (caktimi i zyrtarit përgjegjës për konsultim publik; hartimi i formularit shpjegues dhe dokumentacionit përcjellës; përgatitja e raporteve vjetore dhe raportimi tek kryetari; përcjellja e afateve kohore; dërgimi i raportit tek ministria përgjegjëse për monitorim). Ndërsa, fusha e dytë me një indikator, vlerëson se a është krijuar rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronike.

Të dhënat e përgjithshme nga 34 komunat e monitoruara tregojnë se:

- 76% kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për konsultim publik;
- 32% kanë hartuar formularët shpjegues dhe dokumentacionin përcjellës;
- 32% kanë përcjellë afatet kohore;
- 41% kanë përgatitur raportet vjetore dhe raportuar te kryetari; dhe
- 79% kanë raportuar te Ministria përgjegjëse për monitorim<sup>13</sup>.

Në këta indikatorë, një (1) detyrë (raportimi tek ministria përgjegjëse) në procesin e konsultimit del për Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA) e cila është përmbushur në 26 nga 34 komunat e monitoruara ndërkaq

---

<sup>13</sup> Në nxjerrjen e të dhënave është marrë parasyshë raporti i vlerësimit të transparencës në komuna

tri (3) detyra tjera dalin për zyrtarin përgjegjës për projekt propozim dhe zyrtarin për konsultim publik (të bashkë menaxhuara) ku përmbushja paraqitet si në vijim:

- Në 27 nga 34 komuna - raportimi tek Ministria përgjegjëse për monitorim.
- Në 11 nga 34 komuna - hartimi i formularëve shpjegues dhe dokumentacionit përcjellës;
- Në 11 nga 34 komuna - përcjellja e afateve kohore;
- Në 14 nga 34 komuna - përgatitja e raporteve vjetore dhe raportimi tek kryetari;

Referuar edhe Raportit për Përmbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane (janar-qershor 2023), del se nga 30 komuna që kanë raportuar, 25 komuna kanë caktuar zyrtarin për konsultim publik, ndërkaq 5 komuna (Klllokot, Glllogoc, Ranillug, Fushë Kosovë, Novobërdë) nuk e kanë caktuar ende zyrtarin përgjegjës për koordinim të konsultimit publik<sup>14</sup>.

### Rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronik

Për vlerësimin e rubrikës për konsultim me shkrim dhe elektronik të monitorimit vjetor është vlerësuar një indikatorë në 34 komuna (Rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronik). Te kjo kategori del se:

- 71% e komunave kanë krijuar rubrikën e veçantë në ueb faqet komunale, ndërkaq 29% nuk kanë menu/rubrikë të veçantë.

Në këtë indikator nga vlerësimi i mekanizmit përgjegjës është vlerësuar puna e Zyrtarit Kryesor Administrativ ku del se në 24 nga 34 komuna është përmbushur detyra e krijimit të rubrikës së veçantë.

Nga raporti për Vlerësimin e Transparencës në Komuna (janar-dhjetor 2022) mos funksionimi i ueb faqeve zyrtare të komunave ka krijuar problem në përditësimin me të dhëna dhe funksionimin e rregullt të ueb faqeve zyrtare të komunave. Për shkak të problemeve në ueb faqe zyrtare të komunave, nuk është e mundshme qasja gjatë gjithë kohës dhe krijon vështirësi në hapjen e shpejtë të dokumenteve, saktësinë e të dhënave dhe ka raste kur ueb faqet zyrtare të komunave dalin nga sistemi dhe nuk lejojnë marrjen e informacioneve për dokumente që duhet të jenë të qasshme për publikun brenda afateve të parapara kohore. Po i njëjti raport dhe procesi i monitorimit të konsultimit publik (2023) dëshmojnë se vazhdon të ketë sfida në qasjen në të dhëna. Monitoruesit kanë vazhduar të raportojnë se: ueb faqet e komunave kanë mangësi në gjetjen e të dhënave për proceset e konsultimit publik; të dhënat janë të shpërndara në disa rubrika; si dhe komunat nuk kanë një qasje uniforme të organizimit të dokumentacionit për konsultime publike.

### Planifikimi i konsultimeve publike

Lidhur me vlerësimin e planifikimit të konsultimeve publike janë nxjerrë të dhëna për katër fusha:

1. në fushën e parë, përfshihen përgatitja e planeve si përgatitja e planit të konsultimeve, përfshirja e planit të konsultimeve në planin e punës, përgatitja e planit të veçantë për të gjitha propozimet për konsultime publike.
2. në fushën e dytë, është vlerësuar një indikator: realizimi i konsultimeve në fazat e hershme.
3. në fushën e tretë, për shpalljen e thirrjes për identifikim dhe përfshije të palëve të interesuara në grupet punuese janë vlerësuar dy indikatorë: përfshirja e palëve të interesuara në grupet punuese dhe shpallja e thirrjes publike nga organi propozues për identifikimin e palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese.

<sup>14</sup> [Shqip-Raporti-per-permbushjen-e-obligimeve-te-komunave-nga-Agjenda-Evr...2023.pdf \(rks-gov.net\)](#)

4. në fushën e katërt, përfshihen propozimet nga grupet e jashtme, iniciativat apo komitetet konsultative, me katër indikatorë: nëse ka pasur propozime, ndjekja e rregullave të njëjta për konsultime publike, zhvillimi i konsultimeve nga organi përgjegjës, njoftimi i propozuesve nga zyrtari për konsultim.

### Përgatitja e planeve

Te kategoria e parë nga monitorimi i 34 komunave del se:

- 32% e komunave kanë përfshirë planin e konsultimeve në planin e punës së komunës;
- 65% e komunave kanë përfshirë planin e konsultimeve në hartimin e planit për komunikim publik;
- 32% e komunave zyrtari përgjegjës për konsultim publik harton plan të veçantë për të gjitha projekt propozimet;
- 44% e komunave kanë përgatitur plan për konsultime publike.

Nga këta indikatorë, në dy (2) indikatorët e parë përgjegjës ka qenë Zyrtari Kryesor Administrativ dhe në dy (2) indikatorët vijues zyrtari përgjegjës për konsultim publik, ku niveli i përmbushjes del:

- Në 11 nga 34 komuna, është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në planin e punës së komunës;
- Në 22 nga 34 komuna, është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në hartimin e planit për komunikim publik;
- Në 11 nga 34 komuna, zyrtari përgjegjës për konsultim publik ka hartuar plan të veçantë për të gjitha projekt propozimet;
- Në 15 nga 34 komuna është gjetur i publikuar plani i konsultimeve publike për vitin 2023.

Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës në Komuna (janar-dhjetor 2022), vetëm 19 komuna ose 50% e tyre kanë publikuar planifikimin e konsultimeve publike<sup>15</sup>.

Në fushën e planifikimit të konsultimeve publike në mes viteve 2022 dhe 2023 del se ka një rënie prej 6%, përderisa në vitin 2022 ishte 19 nga 38 komuna apo 50%, ndërsa nga monitorimi konsultimeve publike 2023, në ueb faqe janë gjetur 15 nga 34 komuna, apo 44%, e kjo shënon një rënie të publikimit të planeve për konsultim publik.

### Konsultimi në fazat e hershme

Te kjo fushë nga 16 komunat për të cilat kanë raportuar Zyrtari për Informim del se:

- Vetëm në 6.25% e komunave janë gjetur dhe konfirmuar të dhëna se janë mbajtur konsultime në fazat e hershme;
- Në asnjë komunë, nuk janë gjetur shpalljet për përfshirjen e palëve të interesuara në grupet punuese; në 6.25% e rasteve janë gjetur vendime për përfshirjen e grupeve të interesuara në grupet punuese;
- Në 31% të rasteve janë krijuar bazat e të dhënave për grupet e interesit, në asnjë rast nuk është raportuar për shpallje të thirrjes identifikimin e palëve të interesuara.

---

<sup>15</sup> <https://bitly.ws/3ge82>

Nga dy (2) indikatorët, në këtë kategori mekanizmat përgjegjës/detyrat dalin të bashkë menaxhuara nga zyrtari përgjegjës për konsultim publik dhe zyrtari përgjegjës për projekt propozim.

- Në vetëm 1 nga 16 komuna, është gjetur materiali për konsultime në faza të hershme, përtej dëgjimeve buxhetore;
- Në 5 nga 16 komuna, janë krijuar bazat e të dhënave për grupet e interesit, në asnjë rast nuk është raportuar për shpallje të thirrjes për identifikimin e palëve të interesuara.

### Shpallja e thirrjes për identifikim dhe përfshije të palëve të interesuara në grupet punuese

Te kjo kategori nga 16 komunat që kanë raportuar Zyrat për Informim del se:

- Asnjë komunë nuk ka raportuar shpallje të thirrjes për identifikim dhe përfshije të palëve të interesuara për përfshije në grupet punuese, ndërkaq vetëm 6% e komunave kanë raportuar vendime për përfshirjen e palëve të interesuara në grupet punuese.

Nga vetëm një (1) indikator në këtë kategori, mekanizmat përgjegjës/detyrat janë bashkë menaxhuar nga zyrtari përgjegjës për konsultim publik dhe zyrtari përgjegjës për projekt propozim.

- Në vetëm 1 nga 16 komuna, janë dërguar vendimet ku janë përfshirë palët e interesuara në grupet punuese; në asnjë komunë nuk është raportuar shpallja e thirrjes për identifikim të palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese.

Ngjashëm, Raporti për Përbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane (janar-qershor 2023), thekson se vetëm 19 komuna kanë raportuar se i kanë të hartuara planet e komunikimit, ndërkaq komuna 11 (Istog, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Graçanicë, Shtërpçë, Ranillug, Fushë Kosova, Novobërdë, Shtime), kanë raportuar se nuk i kanë të hartuara planet e komunikimit.

Të dhënat e ndërthurura në mes raporteve periodike të monitorimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe monitorimi i konsultimit publik, konsiderohet se komunat kanë vijuar me përpjekjet për të grumbulluar të dhënat e grupeve të interesit, por kjo ende kufizohet nga mungesa e mekanizmave të konsoliduar të konsultimit (Komitetet Konsultative) si dhe nga mungesa e konsultimit së OShC-ve në hartimin e planeve të konsultimit por edhe një partneriteti më të qëndrueshëm mes komunave dhe OShC-ve.

### Propozimet nga grupet e jashtme punuese, iniciativat apo komitetet konsultative

Te kjo kategori nga 16 komunat për të cilat kanë raportuar Zyrat për Informim del se:

Në asnjë prej komunave nuk është raportuar se ka pasur propozim nga grupet e jashtme, iniciativat qytetare apo Komitetet Konsultative<sup>16</sup>.

Në këtë rast, nga katër fusha, mekanizmat përgjegjës/detyrat janë ndarë në një detyrë të zyrtari përgjegjës për projekt propozimin. Si rezultat i mos pasjes së propozimeve nga grupet e jashtme, iniciativat qytetare apo komitetet konsultative, kjo është përjashtuar nga vlerësimi.

---

<sup>16</sup> Kjo sipas doracaktut për konsultime publike, ka kuptimin e nenit 70 iniciativat qytetare dhe 73 komitetet konsultative të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet.pdf>.

Referuar Raportit të Funksionimit të Kuvendeve Komunale (janar-dhjetor 2022), del se vetëm 11 komuna kanë të themeluara Komitetet Konsultative: 4 komuna nga 1 Komitet Konsultativ; 3 komuna nga 2 Komitete Konsultative dhe 4 komuna nga 3 Komitete Konsultative<sup>17</sup>. Pra, kjo reflektohet edhe në raportin e monitorimit me numër të ulët të propozimeve nga grupet e jashtme në mungesë të trupave konsultative apo përfshirjes së grupeve të interesit.

### Raportimi, bashkëpunimi dhe monitorimi

Lidhur me vlerësimin e raportimit, bashkëpunimit dhe monitorimit janë nxjerrë të dhëna për dy fusha: Fusha e parë, përfshinë vlerësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit me dy indikatorë si (monitorimi nga kryetari i komunës dhe monitorimi nga Kuvendi Komunal). Në fushën e dytë, për koordinim, bashkëpunim dhe raportim janë vlerësuar dy indikatorë (ngritja e kapaciteteve dhe raporti vjetor për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik në komuna).

### Procesi i raportimit dhe monitorimit

Te kjo kategori nga 16 komunat që kanë raportuar del se:

- Në asnjë rast apo 0%, kryetari i komunës nuk ka kthyer prapa për të shkuar për votim në Kuvendin Komunal projekt-propozimet që nuk i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik;
- Në 5% të rasteve është raportuar se Kuvendi Komunal ka kthyer prapa procesin apo refuzuar aktin për miratim si pasojë e mos përmbushjes së standardeve minimale të konsultimit publik.

Në këtë rast, nga dy (2) mekanizmat përgjegjës/detyrat janë ndarë në një rast te Zyrtari Kryesor Administrativ, në një (1) rast Kuvendit Komunal.

- Asnjë nga 16 komunat, që kanë kthyer përgjigjeje Zyrat për Informim nuk ka raportuar se kryetari i komunës nuk ka dërguar për aprovim në Kuvendin Komunal projekt-propozimet që nuk kanë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik;
- Në vetëm 1 nga 16 komunat, që kanë kthyer përgjigjeje Zyrat për Informim është raportuar se Kuvendi Komunal ka refuzuar për miratim projekt propozimin që nuk ka përmbushur standardet minimale të konsultimit publik.

Nga krahasimi i të dhënave me analizën e proceseve buxhetore 2023<sup>18</sup>, del se: nga 38 ueb faqet e komunave, në 25 nuk është gjetur materiali i punës për mbledhjet e Kuvendeve Komunale, në 10 komuna është gjetur materiali për mbledhjen e miratimit të buxhetit, ndërsaq në 3 ueb faqe të komunave publikohen materialet, por nuk u gjet ai për mbledhjen e miratimit të buxhetit. Edhe nga monitorimi del se përkundër se nuk përmbushen standardet, kthimi prapa nga kryetari, apo refuzimet e Kuvendit Komunal për miratim mbesin në nivele tejet të ulëta.

### Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi

Nga të dhënat për të cilat kanë raportuar Zyrat për Informim nga 16 komuna, del se:

- Në 33% të rasteve, MAPL-ja në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit zhvillon aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për konsultim publik;

<sup>17</sup> <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/Raporti-i-funksionimt-te-KK-2022-020-291-2023.pdf>

<sup>18</sup> <https://www.klgi-ks.com/wp-content/uploads/2023/04/Analiza-e-Proceseve-Buxhetore-Komunale-2023.pdf>

- Nuk ka raport të veçantë nga MAPL-ja për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik në komuna (*ekziston vetëm raporti i vlerësimit të transparencës në komuna*).

Në këtë rast, nga dy mekanizmat përgjegjës/detyrat janë ndarë në dy rastet te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ku sipas përbushjes dalin:

- Në 7 nga 16 komuna që kanë kthyer përgjigjeje Zyrtat për Informim, raportohet për zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për konsultim publik;
- Në monitorimin e platformës së konsultimeve publike, e as në ueb faqen e Ministrisë përgjegjëse, nuk gjendet raport i veçantë për konsultimet publike.

Në tabelën 1 janë të paraqitura rezultatet e përmbledhura nga përbushja e njëzet (20) kriterëve të monitorimit vjetor, nisur nga: **Aspekti administrativ dhe teknik** (Aspekti administrativ dhe teknik, rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronike) – 6 indikatorë; **Planifikimi i konsultimeve publike** (Përgatitja e planeve konsultimi në fazat e hershme, shpallja e thirrjes për identifikim dhe përfshije të palëve të interesuara në grupet punuese, propozimet nga grupet e jashtme, iniciativat apo Komitetet Konsultative) – 10 indikatorë; **Procesi i raportimit dhe monitorimit** – 2 indikatorë; **Koordinimi, bashkëpunimi dhe raporti përmbledhës i konsultimeve** (monitorimi nga Ministria përgjegjëse për zbatimin e udhëzimit) – 2 indikatorë.

### Tabelat vjetore të vlerësimit të performancës së konsultimeve publike

Në vijim janë paraqitur dy tabela përmbledhëse, ku në të parën paraqiten përbushja e kriterëve (20) nga proceset e monitorimit vjetor si dhe përbushja e përgjegjësive nga mekanizmat komunal të ndara sipas detyrave. Ndërkaq, në tabelën e dytë paraqiten të dhënat e përbushjes së kriterëve (20) në pesë fusha të ndara (*fusha 1. Aspekti administrativ dhe teknik; fusha 2. Planifikimi i konsultimeve publike; fusha 3. Konsultimi në fazat e hershme me palët e interesuara; fusha 4. Projekt propozimet nga grupet e jashtme punuese; dhe fusha 5. Procesi i raportimit dhe monitorimit të konsultimit publik në Komuna*).

Nga të dhënat e 34 nga 38 komunat e monitoruara, përbushjen më të lartë në totalin e kriterëve (20) e ka komuna e Glllogocit me 60%, e pasuar nga komuna e Lipjanit me 55%, nga komuna e Prizrenit, Rahovecit dhe Mitrovica e Jugut me 50%, si dhe me 45% nga komuna e Kamenicës. Ndërkaq, përbushjen më të ulët e kanë shënuar komuna e Fushë-Kosovës me 10%, e pasuar nga komunat: Graçanica, Deçani dhe Skenderaj me nga 15%.

Tabela përmbledhëse 1: Mbledhja e 20 kriterëve të përbushur nga komunat nga monitorimi vjetorë

<b>Monitorimi Vjetor</b>							
<b>Përbushja e (20) kriterëve nga monitorimi vjetor</b>			<b>Përbushja e përgjegjësive<sup>19</sup></b>				
<b>Komuna</b>	<b>Numri</b>	<b>%</b>	<b>Zyrtari përgjegjës për projekt propozimin (12 detyra)</b>	<b>Zyrtari për Komunikim me Publikun (10 detyra)</b>	<b>Kryetari/spo nsorizuesi (7 detyra)</b>	<b>Kuvendi Komunal (1 detyre)</b>	<b>MAPL/ZQ M (2 detyra)</b>
<b>Deçan</b>	3	15%	1	1	2	0	0
<b>Gjakovë</b>	6	30%	3	2	3	0	0
<b>Glllogoc</b>	12	60%	6	5	4	1	1

<sup>19</sup> Përlllogaritja e përbushjes së detyrave

<b>Gjilan</b>	7	35%	4	4	3	0	0
<b>Dragash</b>	5	25%	2	1	3	0	0
<b>Istog</b>	8	40%	4	3	3	0	1
<b>Kaçanik</b>	5	25%	2	2	3	0	0
<b>Klinë</b>	8	40%	4	4	4	0	0
<b>Fushë-Kosovë</b>	2	10%	1	1	1	0	0
<b>Kamenicë</b>	9	45%	5	4	4	0	0
<b>Leposaviq</b>	Nuk ka informata						
<b>Lipjan</b>	11	55%	6	5	4	0	1
<b>Obiliq</b>	8	40%	5	4	3	0	0
<b>Rahovec</b>	10	50%	5	4	4	0	1
<b>Pejë</b>	6	30%	1	1	5	0	0
<b>Podujevë</b>	5	25%	2	2	2	0	1
<b>Prishtinë</b>	4	20%	1	1	3	0	0
<b>Prizren</b>	10	50%	6	5	4	0	0
<b>Skenderaj</b>	3	15%	1	1	2	0	0
<b>Shtime</b>	6	30%	2	2	4	0	0
<b>Shtërpçë</b>	Nuk ka informata						
<b>Suharekë</b>	4	20%	1	1	3	0	0
<b>Ferizaj</b>	6	30%	3	2	3	0	0
<b>Viti</b>	4	20%	1	1	3	0	0
<b>Vushtrri</b>	6	30%	2	2	4	0	0
<b>Malishevë</b>	6	30%	3	3	3	0	0
<b>Novobërdë</b>	Nuk ka informata						
<b>Mitrovicë e Jugut</b>	10	50%	5	4	4	0	1
<b>Junik</b>	4	20%	1	1	3	0	0
<b>Hani i Elezit</b>	8	40%	5	4	2	0	1
<b>Mamushë</b>	Nuk ka informata						
<b>Graçanicë</b>	3	15%	1	1	2	0	0
<b>Ranillug</b>	Nuk ka informata						
<b>Partesh</b>	Nuk ka informata						
<b>Killokot</b>	Nuk ka informata						

Në tabelën përmbledhëse 2, sipas fushave, del se përmbushjen më të lartë e zënë: aspekti administrativ dhe teknik me 52%, të pasuara nga planifikimi i konsultimeve publike me 44% dhe raportet e konsultimeve publike me 41%. Ndërkaq, nivelin më të ulët e kanë shënuar konsultimi në fazat e hershme me 6%, i ndjekur nga propozimet nga grupet e jashtme<sup>20</sup> me 6% dhe shqyrtimi për të kthyer prapa nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) 0%, si dhe refuzimi nga Kuvendi Komunal dokumentet që nuk kanë përmbushur standardet e konsultimit 6%.

<sup>20</sup> Kjo sipas doracaktut për konsultime publike, ka kuptimin e nenit 70 iniciativat qytetare dhe 73 komitetet konsultative të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet.pdf>.



Te fusha e aspekteve administrative dhe teknike në mungesë të raportit për konsultimin publik në komuna, në raportet e Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale/Zyrës për Qeverisje të Mirë<sup>21</sup>, e dhëna është nxjerrë nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës Komunale (janar-dhjetor 2022)<sup>22</sup>. Përderisa, fusha Procesi i Raportimit dhe Monitorimit të Konsultimit Publik në Komuna është vlerësuar i pa përmbushur në mungesë të raportit.

Nga të dhënat e konsultimeve të hershme, përveç dëgjimeve buxhetore, në vetëm një rast është raportuar nga përgjigjet e 16 Zyrave për Informim, për konsultime në fazat e hershme, para hartimit të draftit. Për këtë, janë vlerësuar konsultimet në fazat e hershme të proceseve si rregulloreve, apo planeve/strategjive komunale pa përfshirë dëgjimet buxhetore. Ndërkaq, nga analiza e proceseve buxhetore në Komuna<sup>23</sup>, nxjerrë nga Instituti KLGI, del se: 20 komuna kanë publikuar raportet nga konsultimet e dëgjimeve buxhetore, ndërkaq vetëm 10 komuna kanë publikuar raportin me komente (pranohet/pjesërisht/refuzohet), 1 komunë ka paraqitur komentet pjesërisht.

Po te kjo fushë, konsultimet në fazat e hershme, nuk raportohet se ka pasur thirrje për identifikimin e palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese. Ndërkaq, njëmbëdhjetë (11) komuna kanë raportuar se në përkrahje të projektit DEMOS/HELVETAS<sup>24</sup> kanë krijuar baza të të dhënave (Excel forma) sipas grupeve të interesit. Në vetëm një (1) rast është raportuar nga përgjigjet e 16 Zyrave për Informim se ka pasur përfshirje të grupeve të interesuara në grupet punuese. Përderisa, sa i përket projekt propozimeve nga grupet e jashtme punuese, në këtë rast iniciativave qytetare, sipas nenit 70 dhe komiteteve konsultative sipas nenit 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nuk janë raportuar. Kjo ka shkaktuar hamendësimin e Zyrave për Informim, duke raportuar përfshirjen e qytetarëve, grupeve të interesit, apo organizatave të shoqërisë civile nëpërmjet komenteve nga konsultimet publike.

Tabela përmbledhëse 2: Përmbushja e kriteve sipas fushave nga monitorimi vjetorë

**Monitorimi Vjetor<sup>25</sup>**

<b>Komuna</b>	<b>Aspekti administrativ dhe teknik (6 detyra)</b>	<b>Planifikimi i konsultimeve publike (4 detyra)</b>	<b>Konsultimi në fazat e hershme me palët e interesuara<sup>26</sup> (3 detyra)</b>	<b>Projekt propozime nga grupet e jashtme punuese (4 detyra)</b>	<b>Procesi i Raportimit dhe Monitorimit të Konsultimit Publik në Komuna (3 detyra)</b>
<b>Deçan</b>	33%	25%	/	/	/
<b>Gjakovë</b>	50%	50%	33%	0%	0%
<b>Glllogoc</b>	100%	100%	33%	0%	25%
<b>Gjilan</b>	83%	25%	33%	0%	0%
<b>Dragash</b>	50%	25%	/	/	/
<b>Istog</b>	67%	75%	33%	0%	25%
<b>Kaçanik</b>	67%	50%	/	/	/

<sup>21</sup> <https://konsultimet.rks-gov.net/documents.php>

<sup>22</sup> <https://bitly.ws/3ge82>

<sup>23</sup> <https://www.klgi-ks.com/wp-content/uploads/2023/04/Analiza-e-Procese-ve-Buxhetore-Komunale-2023.pdf>

<sup>24</sup> The decentralisation and municipal support

<sup>25</sup> Komunitat që kanë të plotësuara fushat me numra, kanë raportuar Zyrat për Informim, ndërkaq ato të paraqitura me vizë janë të mbledhurat nga monitorimi.

<sup>26</sup> Referuar doracakut, Konsultimi në fazat e hershme – Palët do të përfshihen në përgatitjen e draftit sa më herët që është e mundur dhe do të mbesin të angazhuara gjatë gjithë procesit.

<b>Klinë</b>	83%	75%	33% <sup>27</sup>	0%	0%
<b>Fushë-Kosovë</b>	16%	0%	/	/	/
<b>Kamenicë</b>	100%	100%	/	/	/
<b>Leposaviq</b>	-	-	-	-	-
<b>Lipjan</b>	100%	100%	33%	0%	25%
<b>Obiliq</b>	100%	75%	/	/	/
<b>Rahovec</b>	100%	100%	0%	0%	25%
<b>Pejë</b>	50%	75% <sup>28</sup>	/	/	/
<b>Podujevë</b>	67%	0%	0%	0%	25%
<b>Prishtinë</b>	33%	50%	/	/	/
<b>Prizren</b>	100%	100%	/	/	/
<b>Skenderaj</b>	50%	0%	/	/	/
<b>Shtime</b>	67%	50%	0%	0%	0%
<b>Shtërpçë</b>	-	-	-	-	-
<b>Suharekë</b>	50%	25% <sup>29</sup>	/	/	/
<b>Ferizaj</b>	67%	75%	33%	0%	0%
<b>Viti</b>	50%	25%	0%	0%	0%
<b>Vushtrri</b>	67%	50%	/	/	/
<b>Malishevë</b>	83%	25%	0%	0%	0%
<b>Novobërdë</b>	-	-	-	-	-
<b>Mitrovicë e Jugut</b>	100%	100%	0%	0%	25%
<b>Junik</b>	50%	25%	/	/	/
<b>Hani i Elezit</b>	83%	75%	0%	0%	25%
<b>Mamushë</b>	-	-	-	-	-
<b>Graçanicë</b>	50%	0%	0%	0%	0%
<b>Ranillug</b>	-	-	-	-	-
<b>Partesh</b>	-	-	-	-	-
<b>Kllokot</b>	-	-	-	-	-

Në tabelën në vijim, të dhënat janë paraqitur nga databaza e Grantit të Performancës Komunale për vitin 2022. Ndërkaq, rregullat e kalkulimit të të dhënave janë nxjerrë nga dokumenti kryesor i sistemit të menaxhimit të performancës komunale. Referenca shpjeguese e indikatorëve të vlerësuar nga Raporti i Performancës Komunale 2022.

Sipas indikatorëve të performancës 3.1.2 (pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike) dhe 16.2.3 (pjesëmarrja e grave në konsultime publike)

3.1.2. Niveli 3% i numrit të banorëve është marrë si nivel i mjaftueshëm i pjesëmarrjes për të gjitha komunat, së paku për një periudhë të përkohshme. Matja e pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike ka për qëllim përmirësimin e proceseve të demokracisë lokale, duke siguruar

<sup>27</sup> Vetëm në një rast: për Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031.

<sup>28</sup> Plani I Veprimit për Transparencë

<sup>29</sup> Treguesi për përfshirje në planifikimin e konsultimeve publike në hartimin e planit për komunikim publik është siguruar nga raporti i MAPL-së.

transparencë dhe llogaridhënie, si dhe shqyrtimi i çështjeve me interes për publikun. Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e pjesëmarrësve në konsultimet publike të komunës gjatë vitit (e dhëna 1) me 3% e numrit të banorëve në komunë (e dhëna 2) shumëzuar me 100.

**16.2.3.** Llogaritja e treguesit bëhet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të grave në konsultime (e dhëna 2) me numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në konsultime (e dhëna 1), shumëzuar me 100. Pastaj formula shumëzon për 2 vlerën e përpjesëtuar të 2 treguesve.

Nga të dhënat del se, vetëm në 3 komuna është arritur 3% i llogaritur i numrit të banorëve për pjesëmarrje në konsultime publike (Hani i Elezit, Obiliq dhe Ranillug), ndërkaq në vetëm një komunë (Deçan) ka raportuar se është arritur barazia në pjesëmarrjen e grave në konsultimet publike.

Tabela përmbledhëse 3: Të dhënat e raportuara në raportin e performancës për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike të ndara sipas gjinisë							
Nr	Komuna	Numri i Banorëve	3% i banorëve	Numri i raportuar i pjesëmarrjes	Përqindja e raportuar	Pjesëmarrja e grave	Përqindja e barazisë gjinore
1	Deçan	40,019	1,333	255	19.15%	127	100.00%
2	Dragash	33,997	1,133	312	27.55%	0	0.00%
3	Fushë-Kosovë	34,827	1,160	0	0.00%	0	0.00%
4	Gjakovë	94,556	3,152	1666	52.87%	657	80.00%
5	Gjilan	90,178	3,006	433	14.41%	124	57.48%
6	Glllogoc	58,531	1,951	827	42.42%	332	80.26%
7	Gracanicë	10,675	356	210	59.01%	38	35.97%
8	Hani i Elezit	9,403	313	313	100.00%	98	62.17%
9	Istog	39,289	1,310	344	26.30%	56	32.55%
10	Junik	6,084	203	48	23.55%	23	97.56%
11	Kaçanik	33,409	1,114	626	56.23%	206	65.88%
12	Kamenicë	36,085	1,203	391	32.51%	29	14.77%
13	Klinë	38,496	1,283	209	16.27%	14	12.76%
14	Lipjan	57,605	1,920	850	44.26%	349	81.56%
15	Malishevë	54,613	1,820	280	15.38%	56	39.68%
16	Mamushë	5,507	184	0	0.00%	0	0.00%
17	Mitrovicë	71,909	2,397	390	16.27%	76	38.66%
18	Obiliq	21,549	718	718	100.00%	233	65.90%
19	Partesh	1,787	59,567	0	0.00%	0	0.00%
20	Pejë	96,450	3,215	494	15.37%	146	58.87%
21	Podujevë	88,499	2,950	472	16.00%	40	16.94%
22	Prishtinë	198,897	6,630	0	0.00%	0	26.12%
23	Prizren	177,781	5,926	411	6.95%	57	27.49%
24	Rahovec	56,208	1,874	1245	66.47%	169	27.11%
25	Ranillug	3,866	129	129	100.00%	0	0.00%
26	Shtime	27,324	911	165	18.17%	28	33.55%
27	Skenderaj	50,858	1,695	596	35.19%	203	68.06%
28	Suharekë	59,722	1,991	519	26.06%	39	14.76%

29	Viti	46,987	1,566	515	32.91%	188	72.84%
30	Vushtri	69,870	2,329	257	10.78%	84	64.60%


## Monitorimi Individual

Në proceset e monitorimeve individuale të konsultimeve janë përfshirë 34 komuna me nga një (1) proces të konsultimit në tri (3) kategori (dëgjime buxhetore; plane/strategji komunale dhe akte/rregullore komunale) ofrohet një pasqyrim gjithëpërfshirës se si zbatohen konsultimet publike në komuna. E shtrirë në tri (3) nivele të zbatimit: i. Shpallja e thirrjeve; ii. Zhvillimi i takimeve publike; iii. Mbledhja e komenteve dhe adresimi i tyre.

- Nga të dhënat sipas kategorive del se në kategorinë planet/strategjitë komunale, shpallja e thirrjes ka përbushjen më lartë me 74% e pasuar me zhvillimin e procesit me 76% dhe më së ulët qëndron mbledhja dhe adresimi i komenteve me 32%.
- Edhe tek aktet/rregulloret komunale, arritja më e lartë shënohet te shpallja e thirrjes që ka përbushjen më lartë me 64%, e pasuar me zhvillimin e procesit me 66% dhe më së ulët qëndron mbledhja dhe adresimi i komenteve me 36%.
- Ngjashëm edhe te konsultimet e dëgjimeve buxhetore sipas kategorive, shpallja e thirrjes ka përbushjen më lartë me 78%, e pasuar me zhvillimin e procesit me 73% dhe më së ulët qëndron mbledhja dhe adresimi i komenteve me 51%.

Nga të dhënat e paraqitura nga monitorimet individuale të tri proceseve të konsultimeve publike (planet/strategjitë komunale, aktet/rregulloret komunale dhe dëgjimet buxhetore) në të gjitha rastet shpallja e thirrjeve në këtë rast, publikimi i njoftimit për konsultim bashkë me dokumentin ka arritjen më të lartë, në këtë fushë mesataren e ulë që bashkë me njoftimin të paraqitet edhe memorandum i shpjegues (qëllimet e konsultimit, objektivat, si dhe nevoja për përfshirje të publikut). Ngjashëm me shpalljen e thirrjes, paraqitja e memorandumit shpjegues ulë rezultatin e përgjithshëm edhe të zhvillimit të konsultimit publik. Përderisa, tek mbledhja dhe adresimi i komenteve, si rezultat i publikimit të vetëm procesverbaleve dhe jo raporteve me komente del se kjo fushë ka nivelin më të ulët të arritjes. Pra, mund të arritjes. Pra, mund të konstatojmë se aspektet teknike dhe formale të zhvillimit të konsultimeve kanë pasur një progres, megjithatë esenca e konsultimit publik nuk është arritur ende, pra pronësia e publikut në politika lokale.

**Fig. 1 Performanca e përgjithshme e komunave në konsultime publike në përbushjen e kritereve në tri fusha kryesore: Dëgjimet Buxhetore të 28 komunave, Rregulloret Komunale 25 komuna, Planet Komunale 28 komuna.**



## Konsultimet për Dëgjime Buxhetore

### Shpallja publike për konsultim publik

Për vlerësimin e shpalljes publike dhe përmbushjes së obligimeve për hapjen e konsultimeve publike janë monitoruar 9 kriteret të paraqitura në tabelën 4. Për pyetjen se a është bërë shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, në platformën e qeverisë për konsultime publike, në 28 komunitat që kanë mbajtur konsultime për dëgjime buxhetore, 61% e komunave të monitoruara kanë përmbushur këtë obligim. Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqen e komunës është zbatuar në 86% të komunave. Lidhur me informatat e shpalljes publike për datën e nisjes dhe afatin e fundit për komente: 82% e komunave kanë ofruar informata për datën e nisjes dhe 61% e komunave kanë ofruar informata për datën e fundit për komente. Përqindje e ulët është reflektuar në paraqitjen e memorandumëve shpjeguesë në ftesën për takim publik, ku vetëm 18% e komunave kanë zbatuar këtë kriter. Në pyetjen se a është paraqitur adresa për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik, 72% e komunave kanë paraqitur adresën për pranim të komenteve. Tutje, në pyetjen se a janë zhvilluar konsultime me shkrim dhe elektronik, del se 57% e komunave kanë përmbushur këtë kriter. Lidhur me publikimin e projekt propozimit në ueb faqet komunale dhe platformën e-konsultime, 68% e komunave kanë publikuar projekt propozimin në ueb faqet komunale, ndërkaq 46% e tyre kanë bërë publikimin në e-konsultime.

Nga monitorimi për fushat e lartpërmendura, del se përqindja më e lartë e zbatueshmërisë së

obligimeve për hapjen e konsultimeve publike është 89%. Këtë përqindje e reflektojnë Komuna e Kaçanikut, Rahovecit, Prizrenit, Vushtrrisë, Mitrovicës së Jugut dhe Hanit të Elezit. Ndërkaq, përqindjen më të ulët e reflektojnë Komuna e Gjilanit me 11%, Obiliqit me 22%, Graçanicës me 33% dhe Kllokotit me 22%.

Tabela 4: Shpallja Publike për Konsultim Publik

Nr.	Shpallja Publike për Konsultim Publik	% e komunave që kanë përmbushur obligimin
1.	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqe të komunës	61%
2.	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në platformën e qeverisë për konsultime	86%
3.	Data e nisjes	82%
4.	Afati i fundit për komente	61%
5.	Paraqitja e memorandumëve shpjeguesë	18%
6.	Adresa për pranimin e komenteve	72%
7.	Zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik	57%
8.	Publikimi i projekt propozimit në ueb faqet komunale	68%
9.	Publikimi i projekt propozimit në platformën e-konsultime	46%

## Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike

Në vlerësimin e aspektit teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimin e takimeve publike, janë monitoruar 11 indikatorë në 28 komuna me thirrje publike për dëgjime buxhetore. Nga 89% e komunave që kanë zhvilluar takime publike konsultative për dëgjime buxhetore, 75% e komunave kanë shpallur (në ueb faqe zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve, etj.) njoftimin për takim publik konsultativ, së paku 8 ditë kalendarike para mbajtjes së takimit; 86% e komunave kanë përfshirë datën në shpallje të thirrjes, 89% e komunave kanë përcaktuar vendin dhe kohën në thirrje; 71% kanë bashkëngjitur projekt propozim; 21% e komunave kanë përfshirë memorandumimin shpjegues të qëllimit së hapjes së thirrjes; si dhe 75% e komunave kanë ofruar informata për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Lidhur me zhvillimin e takimeve publike, për pyetjen se a e ka kryesuar takimin konsultativ me qytetarë zyrtari për hartimin e projekt-propozimit i caktuar nga organi propozues, 89% e komunave kanë zbatuar këtë kriter; 82% e komunave kanë ofruar shpjegim për përmbajtjen e projekt propozimit para publikut nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit së bashku me zyrtarin për konsultim publik; ndërkaq, në 82% e komunave reflektohet përmbushje për kriterin në evidentimin e propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve.

Komunat me përmbushje më të lartë në njëmbëdhjetë kriteret e monitorimit të aspektit teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimit të takimeve publike janë: Gjakova, Kamenica, Rahoveci, Hani i Elezit, me një total 100%; ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Obiliqi dhe Podujeva me 55%, Shtime me

36%, Vitia me 45% dhe Shtërpca 0%. Përgjithësisht, rezultatet tregojnë përpjekje pozitive të komunave për të siguruar pjesëmarrjen dhe transparencën në procesin konsultativ publik lidhur me aspektin teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimit të takimeve publike, megjithatë ka disa fusha ku shfaqet nevojë për përmirësime, siç është evidentimi i propozimeve të marra nga publiku gjatë konsultimeve dhe memorandumimi shpjegues.

**Tabela 5: Kriteret për vlerësim të aspektit teknik**

Nr.	Kriteret për vlerësim të aspektit teknik	%
1.	Mbajtja e takimeve publike konsultative	89%
2.	Shpallja e njoftimit për takimin së paku 8 ditë kalendarik	75%
3.	Data e mbajtjes së takimit	86%
4.	Vendi i mbajtjes së takimit	89%
5.	Koha e mbajtjes së takimit	89%
6.	Projekt propozimi	71%
7.	Memorandumi shpjegues	21%
8.	Informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve	75%
9.	Kryesimi i takimit konsultativ nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit	89%
10.	Shpjegimi i përmbajtjes së projekt propozimit para publikut	82%
11.	Evidentimi i propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve	82%



## Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre

Në fushat lidhur me mbledhjen e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre janë evidentuar këto të dhëna: nga 28 komuna të monitoruara, 68% e tyre kanë përgatitur raportin për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit; 61% e komunave kanë përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet nga publiku; 46% e komunave kanë shqyrtuar komentet (pranuara/refuzuara) nga grupi punues; 64% e komunave kanë publikuar raportin brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente); si dhe 14% e komunave kanë paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit.

Komunat me përmbushje më të lartë në katër kriteret e monitorimit janë: Glogoci, Lipjani, Prizreni, Rahoveci me një total 100%; ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Kaçaniku, Fushë-Kosova, Obiliqi, Podujeva, Prishtina, Shtërpca, Vitia dhe Graçanica me 0%, në katër fushat e monitoruara lidhur me mbledhja e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre.

**Tabela 6: Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre**

<b>Nr.</b>	<b>Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre</b>	<b>%</b>
1.	Përgatitja e raportit për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit	68%
2.	Përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku	61%
3.	Shqyrtimi i komenteve (pranuara/refuzuara) nga grupi punues	46%
4.	Publikimi i raportit brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente)	64%
5.	Paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit	14%

## Konsultimet Publike për Rregulloret Komunale

### Shpallja publike për konsultim publik

Për vlerësimin e shpalljes publike dhe përmbushjes së obligimeve për hapjen e konsultimeve publike janë monitoruar nëntë kritere në 25 komuna (shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqe të komunës dhe në platformën e qeverisë për konsultime; data e nisjes, afati i fundit për komente, paraqitja e memorandumeve shpjeguese, adresa për pranimin e komenteve, publikimi i raporteve/rezultateve të konsultimit publik, zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik, publikimi i projekt propozimit në ueb faqet komunale dhe platformën e-konsultime). Për pyetjen se a është bërë shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në platformën e qeverisë për konsultime publike, nga 25 komuna të monitoruara, 80% e tyre kanë përmbushur këtë obligim. Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, në ueb faqet e komunave është zbatuar në 96% të komunave. Lidhur me informatat e shpalljes publike për datën e nisjes dhe afatin e fundit për komente; 92% e komunave kanë ofruar informata për datën e nisjes dhe 80% e komunave kanë ofruar informata për datën e fundit për komente. Përqindje e ulët është reflektuar në paraqitjen e memorandumeve shpjeguese në ftesën për takimin publik, ku vetëm 28% e komunave kanë zbatuar këtë kriter. Në pyetjen se a është paraqitur adresa për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik, 92% e komunave kanë paraqitur adresën për pranim të komenteve. Tutje, në pyetjen se a janë zhvilluar konsultime me shkrim dhe elektronik, del se 80% e komunave kanë përmbushur këtë

kriter. Lidhur me publikimin e projekt propozimit në ueb-faqet komunale dhe platformën e-konsultime, 96% e komunave kanë publikuar projekt propozimin në ueb faqet komunale, ndërkaq 84% e tyre kanë bërë publikimin në e-konsultime.

Nga monitorimi për fushat e lartpërmendura, del se përqindja më e lartë e zbatueshmërisë është 100%. Këtë përqindje e reflektojnë komuna e Prishtinës, Hanit të Elezit dhe Graçanicës. Ndërkaq, përqindjen më të ulët e reflektojnë komuna e Kamenicës me 67%, Pejës 56%, Klinës me 33%, dhe Shtërpçës me 22%.

Tabela 7: Shpallja Publike për Konsultim Publik

Nr.	Shpallja Publike për Konsultim Publik	%
1.	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqe të komunës	96%
2.	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në platformën e qeverisë për konsultime	80%
3.	Data e nisjes	92%
4.	Afati i fundit për komente	80%
5.	Paraqitja e memorandumeve shpjeguese	28%
6.	Adresa për pranimin e komenteve	92%
7.	Zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik	80%
8.	Publikimi i projekt propozimit në ueb faqet komunale	96%
9.	Publikimi i projekt propozimit në platformën e-konsultime	84%

## Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike

Në vlerësimin e aspektit teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimit të takimeve publike, janë monitoruar 11 indikatorë në 25 komuna që kanë ofruar konsultime për rregullore komunale. Nga 92% e komunave që kanë zhvilluar takime publike konsultative për rregullore të komunës, 84% e komunave kanë shpallur (në ueb faqe zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve, etj) njoftimi për takim publik konsultativ, së paku 8 ditë kalendarike para mbajtjes së takimit; 96% e komunave kanë përfshirë datën në shpallje të thirrjes, 100% e komunave kanë përcaktuar vendin; 96% e tyre kanë ofruar informata për kohën e konsultimeve; 84% kanë bashkëngjitur projekt propozim; 16% e komunave kanë përfshirë memorandumimin shpjegues të qëllimit të hapjes së thirrjes; si dhe 84% e komunave kanë ofruar informata për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Lidhur me zhvillimin e takimeve publike, për pyetjen se a e ka kryesuar takimin konsultativ me qytetarë zyrtari për hartimin e projekt propozimit i caktuar nga organi propozues, 76% e komunave kanë zbatuar këtë kriter; 72% e komunave kanë ofruar shpjegim për përmbajtjen e projekt-propozimit para publikut nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit së bashku me zyrtarin për konsultim publik; ndërkaq, në 64% të komunave reflektohet përmbushje për kriterin në evidentimin e propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve.

Komunat me përmbushje më të lartë në njëmbëdhjetë kriteret e monitorimit janë: Kamenica, Skenderaj, Hani i Elezit me një total 100%, ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Gjakova Shtërpca, Suhareka me 45%.

Përgjithësisht, rezultatet tregojnë përpjekje pozitive të komunave për të siguruar pjesëmarrjen dhe transparencën në procesin

konsultativ publik lidhur me aspektin teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimit të takimeve publike. Megjithatë, ka disa fusha ku shfaqet nevojë për përmirësime, siç është evidentimi i propozimeve të marra nga publiku gjatë konsultimeve dhe memorandumimi shpjegues.

**Tabela 8. Kriteret për vlerësim të aspektit teknik**

Nr.	Kriteret për vlerësim të aspektit teknik	%
1.	Mbajtja e takimeve publike konsultative	92%
2.	Shpallja e njoftimit për takimin së paku 8 ditë kalendarike.	84%
3.	Data e mbajtjes së takimit;	96%
4.	Vendi i mbajtjes së takimit;	100%
5.	Koha e mbajtjes së takimit;	96%
6.	Projekt propozimi	84%
7.	Memorandumi shpjegues	16%
8.	Informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve	84%
9.	Kryesimi i takimit konsultativ nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit	76%
10.	Shpjegimi i përmbajtjes së projekt propozimit para publikut	72%
11.	Evidentimi i propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve	64%

## Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre

Në fushat lidhur me mbledhjen e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre, në 25 komuna, janë evidentuar këto të dhëna: 52% e komunave kanë përgatitur raportin për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit; 52% e komunave kanë përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku; 32% e komunave kanë shqyrtuar komentet (pranuara/refuzuara) nga grupi punues; 44% e komunave kanë publikuar raportin brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente); si dhe në asnjë komunë nuk është paraqitur tek materialet e punës raporti i konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit.

Komunat me përmbushje më të lartë në katër kriteret e monitorimit janë: Glllogoci, Klina, Prishtina, Skenderaj, Shtime me një total 80%; ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Gjakova, Dragashi, Kaçaniku, Fushë-Kosova, Podujeva, Peja, Prizreni, Shtërpca, Suhareka, Vitia, Mitrovicë e Jugut me 0% në katër fushat e monitoruara lidhur me mbledhja e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre.

**Tabela 9: Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre**

<b>Nr.</b>	<b>Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre</b>	<b>%</b>
1.	Përgatitja e raportit për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit	52%
2.	Përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet, vërejtjet nga publiku	52%
3.	Shqyrtimi i komenteve (pranuara/refuzuara) nga grupi punues	32%
4.	Publikimi i raportit brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente)	44%
5.	Paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit	0%

## Konsultim Publik për Planin Komunal

### Shpallja Publike për Konsultim Publik

Për vlerësimin e shpalljes publike dhe përmbushjes së obligimeve për hapjen e konsultimeve publike janë monitoruar nëntë kritere në 28 komuna (shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqe të komunës dhe në platformën e qeverisë për konsultime; data e nisjes, afati i fundit për komente, paraqitja e memorandumëve shpjeguese, adresa për pranimin e komenteve, publikimi i raporteve/rezultateve të konsultimit publik, zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik, publikimi i projekt propozimit në ueb faqet komunale dhe platformën e-konsultime). Për pyetjen se a është bërë shpallja e njoftimeve, për konsultim të projekt propozimeve, në platformën e qeverisë për konsultime publike, 61% e komunave të monitoruara kanë përmbushur këtë obligim. Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, në ueb faqet e Komunave është zbatuar në të gjitha komunat. Lidhur me informatat e shpalljes publike për datën e nisjes dhe afatin e fundit për komente, 89% e komunave kanë ofruar informata për datën e nisjes dhe 85% e komunave kanë ofruar informata për datën e fundit për komente. Përqindje e ulët është reflektuar në paraqitjen e memorandumëve shpjeguese në ftesën për takimin publik, ku vetëm 21% e komunave kanë zbatuar këtë kriter. Në pyetjen se a është paraqitur adresa për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik, 93% e komunave kanë paraqitur adresën për pranim të komenteve. Tutje, në pyetjen se a janë zhvilluar konsultime me shkrim dhe elektronik, del se 71% e komunave kanë përmbushur këtë kriter. Lidhur me publikimin e projekt propozimit në ueb faqet komunale dhe platformën e-konsultime, 89% e komunave kanë publikuar

Projekt propozimin në ueb faqet komunale, ndërkaq 64% e tyre kanë bërë publikimin në e-konsultime. Nga monitorimi për fushat e lartpërmendura, del se përqindja më e lartë e zbatueshmërisë është 89%. Këtë përqindje e reflektojnë komunat: Gjakova, Istogu, Lipjani, Podujeva, Prishtina, Prizreni, Ferizaj, Rahoveci, Vitia, Malisheva dhe Hani i Elezit me 89%. Ndërkaq, përqindjen më të ulët e reflektojnë komuna e Gjilanit dhe Shtërpçës me 11%, komuna e Dragashit, Klinës, Pejës, Fushë-Kosovës, Kamenicës, Skenderajt, Shtimes, Vushtrrisë me 67%.

Tabela 10: Shpallja Publike për Konsultim Publik

Nr.	Shpallja Publike për Konsultim Publik	%
1.	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në ueb faqe të komunës	100%
2	Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në platformën e qeverisë për konsultime	61%
3.	Data e nisjes;	89%
4.	Afati i fundit për komente	85%
5.	Paraqitja e memorandumëve shpjeguese	21%
6.	Adresa për pranimin e komenteve	93%
7.	Zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik	71%
8.	Publikimi i projekt propozimit në ue -faqet komunale	89%
9.	Publikimi i projekt-propozimit në platformën e-konsultime	64%

## Aspekti teknik i shpalljes së thirrjes dhe zhvillimi i takimeve publike

Në vlerësimin e aspektit teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimin e takimeve publike, janë monitoruar njëmbëdhjetë indikatorë në 28 komuna që kanë mbajtur konsultime për planin komunal. Nga 89% të komunave që kanë zhvilluar takime publike konsultative për planin komunal, 86% e komunave kanë shpallur (në ueb faqe zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve, etj.) njoftimin për takim publik konsultativ së paku 8 ditë kalendarike para mbajtjes së takimit; 96% e tyre kanë përfshirë datën, vendin dhe kohën në shpallje të thirrjes; 86% kanë bashkëngjitur projekt propozim; 29% e komunave kanë përfshirë memorandumin shpjegues të qëllimit së hapjes së thirrjes; si dhe 92% e komunave kanë ofruar informata për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Lidhur me zhvillimin e takimeve publike, për pyetjen se a e ka kryesuar takimin konsultativ me qytetarë zyrtari për hartimin e projekt propozimit i caktuar nga organi propozues, 75% e komunave kanë zbatuar këtë kriter; 64% e komunave kanë ofruar shpjegim për përmbajtjen e projekt propozimit para publikut nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit së bashku me zyrtarin për konsultim publik; ndërkaq, në 50% të komunave reflektohet përmbushje për kriterin në evidentimin e propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve.

Komunat me përmbushje më të lartë në njëmbëdhjetë kriteret e monitorimit janë: Kamenica, Prishtina, Shtime dhe Hani i Elezit, me një total 100%, ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Fushë-Kosova, Suhareka, Malisheva me 55%, Gjlani me 45% dhe Shtërpca me 36%.

Përgjithësisht, rezultatet tregojnë përpjekje pozitive të komunave për të siguruar pjesëmarrjen dhe transparencën në procesin konsultativ publik lidhur me aspektin teknik të shpalljes së thirrjes dhe zhvillimit të takimeve publike. Megjithatë, ka disa fusha ku shfaqet nevoja për përmirësime, siç është evidentimi i propozimeve të marra nga publiku gjatë konsultimeve dhe memorandumi shpjegues.

**Tabela 11: Kriteret për vlerësim të aspektit teknik**

Nr.	Kriteret për vlerësim të aspekt teknik	%
1.	Mbajtja e takimeve publike konsultative	89%
2.	Shpallja e njoftimit për takimin së paku 8 ditë kalendarike	86%
3.	Data e mbajtjes së takimit	96%
4.	Vendi i mbajtjes së takimit	96%
5.	Koha e mbajtjes së takimit	96%
6.	Projekt propozimi	85%
7.	Memorandumi shpjegues	29%
8.	Informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve	93%
9.	Kryesimi i takimit konsultativ nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit	75%
10.	Shpjegimi i përmbajtjes së projekt propozimit para publikut	64%
11.	Evidentimi i propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve	50%

## Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre

Për 28 komuna të monitoruara lidhur me mbledhjen e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre janë evidentuar këto të dhëna: 43% e komunave kanë përgatitur raportin për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit; 39% e komunave kanë përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku; 32% e komunave kanë shqyrtuar komentet (pranuara/refuzuara) nga grupi punues; 42% e komunave kanë publikuar raportin brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente); si dhe 4% e komunave kanë paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit.

Komuna me përmbushje më të lartë në pesë kriteret e monitorimit është: Rahoveci me 100%; ndërkaq, komunat me performancë më të ulët janë: Kaçaniku, Fushë-Kosova, Obiliq, Podujeva, Prishtina, Shtërpca, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Mitrovica e Jugut, Graçanica me 0% në katër fushat e monitoruara lidhur me mbledhjen e komenteve, komunikimin dhe adresimin e tyre.

**Tabela 12: Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre**

<b>Nr.</b>	<b>Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre</b>	<b>%</b>
1.	Përgatitja e raportit për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit	43%
2.	Përfshirja në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku	39%
3.	Shqyrtimi i komenteve (pranuara/refuzuara) nga grupi punues	32%
4.	Publikimi i raportit brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente)	42%
5.	Paraqitja e raportit të konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit	4%

## Tabelat e vlerësimeve individuale të performancës së konsultimeve

Në tabelën 13 janë të paraqitura të dhënat e përbushjes së njëzetegjashtë (26) kriterëve sipas komunave dhe tri (3) kategori të monitoruara të konsultimeve publike (dëgjime buxhetore, akte/rregulloreve komunale dhe planeve/strategjive). Edhe pse shumë afër, numrin më të lartë të përbushjes e reflektojnë konsultimet për planet/strategjitë komunale me 69% përcjellë nga konsultimet nga dëgjimet buxhetore me 67% dhe aktet/rregulloret komunale me 64%.

Tabela përmbljedhëse 13: Performanca e përgjithshme e komunave në konsultime publike, vlerësimet individuale referuar (26) kriterëve						
Komuna	Kriteret e përbushura për dëgjime buxhetore		Kriteret e përbushura për rregullore komunale		Kriteret e përbushura për plane komunale	
	Numri i përbushjes së kriterëve	%	Numri i përbushjes së kriterëve	%	Numri i përbushjes së kriterëve	%
Deçan	-	-	77	20%	18	69%
Gjakovë	22	84%	14	54%	21	81%
Glogoc	23	88%	21	81%	21	81%
Gjilan	14	54%	0	0%	9	35%
Dragash	20	77%	13	50%	15	57%
Istog	21	81%	23	88%	19	73%
Kaçanik	17	65%	18	69%	17	65%
Klinë	20	77%	15	57%	21	81%
Fushë-Kosovë	17	65%	17	65%	13	50%
Kamenicë	22	85%	22	85%	22	85%
Lipjan	19	73%	21	81%	23	88%
Obiliq	9	35%	-	0%	17	65%
Rahovec	25	96%	24	92%	22	85%
Pejë	21	81%	15	58%	17	65%
Podujevë	7	27%	17	65%	16	62%
Prishtinë	18	69%	22	85%	20	77%
Prizren	24	92%	22	85%	21	81%
Skenderaj	22	85%	23	88%	20	77%
Shtime	13	50%	23	88%	22	85%
Shtërpcë	-	0%	8	31%	-	0%
Suharekë	21	81%	13	50%	14	84%
Ferizaj	17	65%	21	81%	21	81%
Viti	11	42%	15	58%	16	61%
Vushtrri	22	85%			15	58%
Malishevë	16	61%	19	73%	15	58%
Novobërdë	Nuk ka informata		Nuk ka informata		Nuk ka informata	



<b>Mitrovicë e Jugut</b>	23	88%	19	73%	18	69%
<b>Junik</b>						
<b>Hani i Elezit</b>	25	96%	25	96%	24	92%
<b>Mamushë</b>	Nuk ka informata		Nuk ka informata		Nuk ka informata	
<b>Graçanicë</b>	13	50%	23	88%	16	69%
<b>Ranillug</b>	Nuk ka informata		Nuk ka informata		Nuk ka informata	
<b>Partesh</b>	Nuk ka informata		Nuk ka informata		Nuk ka informata	
<b>Kllokot</b>	Nuk ka informata		Nuk ka informata		Nuk ka informata	

Në tabelën 14, janë paraqitur të dhënat në përmbushjen e kriterëve në tri kategori (dëgjime buxhetore, akte/rregullore komunale dhe plane/strategji komunale), të ndara me nga tri fusha (shpallja e njoftimeve, zhvillimi i takimeve dhe mbledhja e komenteve).

Te fusha e shpalljes së njoftimeve, arritjet më të larta shënohen në paraqitjen e këtyre të dhënave: 88% data e nisjes së takimit; 86% shpallja e njoftimeve për konsultime në ueb faqe dhe adresa e pranimit të komenteve si dhe 84% publikimi në ueb faqe; 76% dhe 75%, paraqiten shpallja e njoftimeve në platformën e konsultimeve dhe afati i fundit për komente; 69% zhvillimi i konsultimeve me shkrim dhe elektronik; si dhe 22% paraqitja e memorandumeve shpjeguese. Kjo vjen si rezultat i dy faktorëve, e para, që njoftimi është shtrirë në aktin formal (vendimin për konsultim) e që mungon paraqitja e memorandumeve shpjeguese, dhe e dyta, që njësia (drejtoria, zyra e kryetarit) që në planifikim të konsultimeve publike nuk i ka vendosur qëllimin e konsultimit, objektivave dhe nevojën për përfshirje të grupeve të interesit dhe qytetarëve.

Te fusha për vlerësimin e aspekt teknik, arritjet më të larta shënohen në paraqitjen e këtyre të dhënave: 95% vendi i mbajtjes së takimit; 94% koha e mbajtjes së takimit; 93% data e mbajtjes së takimit; 90% mbajtja e takimeve publike konsultative; 84% informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve; 82% shpallja e njoftimit për takimin, së paku 8 ditë kalendarike; 80% projekt propozimi; 80% kryesimi i takimit konsultativ nga zyrtari për hartimin e projekt propozimit; 73% shpjegimi i përmbajtjes së projekt propozimit para publikut; 65% evidentimi i propozimeve të dhëna nga publiku gjatë konsultimeve; 22% memorandumi shpjegues. Mungesa e memorandumeve shpjeguese përcillet që nga shpallja e thirrjes edhe tek zhvillimi i proceseve të konsultimeve publike në teren.

Te fusha për mbledhjen e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre, arritjet më të larta shënohen në paraqitjen e këtyre të dhënave: 54% përgatitja e raportit për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit; 51% përfshirja në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku; 37% shqyrtimi i komenteve (pranuar/refuzuara) nga grupi punues; 50% publikimi i raportit brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente); 18% kanë paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit.

Në procesin e monitorimit është ndjekur rruga nga shpallja deri tek paraqitja e raportit të konsultimit në kuvendin komunal. Të dhënat tregojnë një shkallshmëri rënëse të përmbushjes, ku vetëm në gjysmën e rasteve që janë monitoruar kanë hartuar raportet për rezultate të konsultimit, menjëherë shihet rënia në paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve të publikut, kjo bie edhe më shumë në paraqitjen e komenteve të shqyrtuara për të shënuar rezultatin më të ulët të raporteve të konsultimeve publike në bashkëngjitjen e

materialeve të punës për kuvendin komunal. Në një vrojtim të përgjithshëm të procesit del se edhe pse më shumë se në gjysmën e rasteve është publikuar raporti me rezultatet e konsultimit, në vlerësimin për brenda përmbushjes së standardeve në raport vërehet një përmbushje ndjeshëm e ulët. Ndërkaq, përdorimi i këtij raporti nga politik bërësit dhe vendimmarrësit në këtë rast kryetari i komunës nuk sigurohet që akti që shkon për miratim në kuvendin komunal ti përmbush standardet e konsultimit publik, e në anën tjetër, kuvendi komunal nuk kthen mbrapa aktet e propozuara për miratim që nuk kanë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik.

Tabela përmblhedhëse 14: Performanca e monitorimit individual sipas kategorive dhe fushave																		
Komuna	Rregulloret e komunës						Dëgjimet Buxhetore						Planet Komunale					
	Shpallja e njoftimeve		Zhvillimi i takimeve		Mbledhja e komenteve dhe adresimi		Shpallja e njoftimeve		Zhvillimi i takimeve		Mbledhja e komenteve dhe adresimi		Shpallja e njoftimeve		Zhvillimi i takimeve		Mbledhja e komenteve dhe adresimi	
	10 indikatorë		11 indikatorë		5 indikatorë		10 indikatorë		11 indikatorë		5 indikatorë		10 indikatorë		11 indikatorë		5 indikatorë	
Deçan	10	100%	10	90.91 %	0	0%	/	/	/	/	/	/	9	90%	9	81.82 %	0	0%
Gjakovë	9	90%	5	45.45 %	0	0%	7	70%	11	100%	4	80%	10	100%	8	72.73 %	3	60%
Gllgoc	8	80%	9	81.82 %	4	80%	8	80%	10	90.91 %	5	100%	8	80%	10	90.91 %	3	60%
Gjilan	/ <sup>30</sup>	/	/	/	/	/	2	20%	10	90.91 %	3	60%	2	20%	5	45.45 %	3	60%
Dragash	7	70%	7	63.64 %	0	0%	6	60%	10	90.91 %	4	80%	7	70%	8	72.73 %	0	0%
Istog	9	90%	10	90.91 %	3	60%	7	70%	10	90.91 %	4	80%	9	90%	9	81.82 %	1	20%
Kaçanik	9	90%	9	81.82 %	0	0%	9	90%	8	72.73 %	0	0%	8	80%	9	81.82 %	0	0%
Klinë	4	40%	7	63.64 %	4	80%	6	60%	10	90.91 %	4	80%	7	70%	10	90.91 %	4	80%
Fushë-Kosovë	9	90%	8	72.73 %	0	0%	7	70%	10	90.91 %	0	0%	7	70%	6	54.55 %	0	0%
Kamenicë	7	70%	11	100%	4	80%	7	70%	11	100%	4	80%	7	70%	11	100%	4	80%
Lipjan	8	80%	9	81.82 %	4	80%	5	50%	9	81.82 %	5	100%	9	90%	10	90.91 %	4	80%
Obiliq	/	/	0	0%	0	0%	3	30%	6	54.55 %	0	0%	8	80%	9	81.82 %	0	0%
Rahovec	9	90%	10	90.91 %	4	80%	9	90%	11	100%	5	100%	9	90%	9	81.82 %	5	100%
Pejë	6	60%	9	81.82 %	0	0%	8	80%	10	90.91 %	3	60%	7	70%	10	90.91 %	0	0%
Podujevë	8	80%	9	81.82 %	0	0%	0	0%	6	54.55 %	0	0%	9	90%	7	63.64 %	0	0%

<sup>30</sup> (/) e paraqitura në tabelë nënkuptojnë se nuk janë gjetur të dhëna, ndërsa për fushat e vlerësuara me 0 nuk janë publikuar të dhënat në ueb-faqe komunale dhe janë të konfirmuara nga zyrat për informim



## Te gjeturat nga raportet relevante të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Në tabelat në vijim, paraqiten të dhëna nga raportet periodike të monitorimit të komunave nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ku janë nxjerrë informacione për nivelin e përmbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Këto të dhëna shërbejnë për të ofruar informacione të përmbledhura për kontekstin, si dhe për të parë nga afër sfidat e komunave në zbatimin e procesit të konsultimit publik. Njëkohësisht, paraqesin relevancën e konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala nga procesi i monitorimit si dhe një dimension shtesë për krahasime në nivel të arritjeve.

### Raporti për Përmbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane (janar-qershor) 2023<sup>31</sup>

Gjetja	Komenti	Rekomandimi
<p>Nga 30 komuna raportuese në 16 komuna është hartuar Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, ndërsa 14 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Shtërpcë, Ranillug, Gjilan, Fushë-Kosovë, Novobërdë ) ende nuk e kanë hartuar.</p> <p>Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani 19 Komuna e kanë hartuar, ndërsa 11 Komuna (Istog, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Graçanicë, Shtërpcë, Ranillug, Fushë Kosova, Novobërdë, Shtime) ende nuk kanë hartuar.</p>	<p>Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, pasqyrohet numri i komunave që kanë raportuar se kanë hartuar Strategjitë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun.</p>	<p>Të hartohet Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në komunat: Kamenicë, Viti, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Shtërpcë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Novobërdë.</p>
<p>Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, janë 29 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Han i Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpcë, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë-Kosovë, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan) të cilat kanë raportuar që është duke u</p>	<p>Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura (25 Komuna kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunë, ndërsa në 5 Komuna ende nuk kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik). Nga kjo mund të vërejmë që ende nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur, pasi që rezultatet e konsultimit publik me</p>	<p>Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësi/zyrtari për komunikim publik.</p>

<sup>31</sup> <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/Shqip-Raporti-per-permbushjen-e-obligimeve-te-komunave-nga-Agjenda-Evr...2023.pdf>

zbatuar ky udhëzim, në 1 komunë (Ferizaj) është duke u zbatuar pjesërisht.	raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të komunave.	
--	---	--

### Raporti për Vlerësimin e Transparencës në Komuna (janar-dhjetor) 2022<sup>32</sup>

Gjetja	Komenti	Rekomandimi
Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik obligon autoritetet lokale që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovojë transparencë komunale, si dhe të ndikojë në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm. Bazuar në nenin 5 Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik, komuna siguron publikimin e projekt propozimeve në ueb faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel qendror.	Obligimin ligjor për caktimin e zyrtarit përgjegjës për konsultime publike e kanë caktuar 28 komuna, krahasuar me vitin 2021, kemi rritje të dukshme prej 6 komuna më shumë gjatë vitit 2022; prej 38 komunave gjatë vitit 2021, zyrtarin përgjegjës për konsultime publike e kanë caktuar 22 komuna.	Komunat duhet të fillojnë me përgatitjen e raporteve kthyesë pas përmbylljes së konsultimeve publike, në mënyrë që qytetarët dhe grupet e interesit të informohen për çështjet, të cilat i kanë adresuar dhe arsyet për mospranimin e propozimeve. Komunat duhet të dorëzojnë raportin e konsultimeve publike, së bashku me projekt aktin e propozuar për aprovim në Kuvendin Komunal. Projekt propozimet, të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.
Sipas të dhënave, gjatë vitit 2022, raportet e konsultimeve publike i kanë publikuar 17 komuna, për derisa 21 të tjera kanë dështuar në përmbushjen e këtij obligimi ligjorë.	Krahasuar me të dhënat e vitit 2021, gjatë vitit 2022 kemi një rritje të dukshme prej 12 komuna në publikimin e Raporteve të konsultimeve publike gjatë vitit 2022.	Rekomandohet komunat t'i plotësojnë kriteret (format) e raporteve, emërtimet e dokumenteve tjera dhe të publikohen me kohë te linku për konsultimet publike, ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik.

<sup>32</sup> <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F04%2FRAPORTI-PER-VLERESIMIN-E-TRANSPARENCES-03.04.2023- Shq -LEKTORUAR.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

		Rekomandimet tjera për komuna, janë publikimi i projekt propozimeve (projekt akteve) të publikuara në faqen zyrtare të komunës, për të cilat kërkohet konsultimi i qytetarëve dhe t'i vendosin te linku i konsultimeve publike dhe jo te debatet publike, gjë që krijon edhe vështirësi për të dhëna të sakta.
--	--	--

### Raporti i Performancës së Komunave (janar-dhjetor) 2022<sup>33</sup>

Gjetja	Komenti	Rekomandimi
Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilët pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, shërbimet administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. Me hartimin e këtyre raporteve kanë filluar 33.12% e komunave (Gjilani, Glllogoci, Hani i Elezit, Juniku, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Peja, Podujeva, Prizreni, Rahoveci Skenderaj, Suhareka Podujeva).	Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë bërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.	Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

<sup>33</sup> <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/Raporti-i-Performances-se-Komunave-janar-Dhjetor-2022.pdf>

## Konkluzione dhe Rekomandime

Në këtë tabelë janë të paraqitura konkluzionet dhe rekomandimet, të ndara në tri dimensione: i. Të përgjithshme - ofrojnë një pasqyrim të gjerë të gjendjes; ii. Të ndërthurura - krahasojnë raportet e monitorimit në fusha me gjetjet e monitorimit; si dhe iii. Specifike - paraqesin gjendjen nga raporti i monitorimit. Gjetjet të nxjerra si konkluzionet dhe rekomandimet u shërbejnë komunave në përmirësimin e gjendjes, hartuesve të politikave për të parë problemet, si dhe akterëve tjerë si shoqëria civile, për të harmonizuar angazhimin e tyre me kontekstin.

### Të përgjithshme

Konkluzione	Rekomandime
Në ueb faqet e komunave mungojnë të dhënat për proceset e konsultimit publik.	Të përmirësohet qasja dhe struktura e ueb faqeve komunale.
Të dhënat janë të shpërndara në disa rubrika. Komunitat nuk kanë një qasje uniforme të organizimit të dokumentacionit për konsultime publike.	Të krijohet një qasje uniforme e organizimit të dokumentacionit për konsultime publike.
Komunitat vazhdojnë të mos publikojnë dokumentet në platformën qeveritare të konsultimeve publike.	Të publikohen të gjitha dokumentet e konsultimeve publike në platformën qeveritare të konsultimeve publike.
Planifikimi i konsultimeve publike mbetet i ulët, po ashtu ekziston një hendek mes planifikimit dhe raportimit të konsultimeve publike.	Të rritet niveli i planifikimit të konsultimeve publike.  Të nxirren të dhëna mbi nivelin e përmbushjes dhe të hartohen raportet vjetore.
Formularët shpjegues dhe dokumentacioni përcjellës, mbetet në nivele të ulëta, ekziston një shkëputje e procesit mes njësisë që propozon dokumentin për konsultim, koordinatorit për konsultim publik dhe Zyrës për Marrëdhënie me Publikun.	Të përmirësohen dokumentacionet përcjellëse të konsultimit publik si dhe të rritet koordinimi në mes akterëve.
Thirrjet dhe memorandumet shpjeguese, mbesin të mangëta. Kryesisht, thirrja bazohet në vendimet e kuvendit për nxjerrjen e aktit në konsultim publik, por që nuk publikohet njoftim i veçantë me memorandum shpjegues në ueb faqet komunale.	Të ofrohen informacione të përmbledhura dhe të bëhen të qarta objektivat, arsyeja dhe nevoja e kontributit të qytetarëve dhe profesionistëve.



Për dallim nga kjo, në platformën qeveritare të konsultimeve, paraqiten më tepër informacione lidhur me procesin e konsultimit sipas memorandumit shpjegues.	
Publikimi i procesverbaleve/raporteve, mbetet i ulët. Ka një dallim në numrin e publikimit të procesverbaleve dhe raporteve me komente. Për më tepër ato janë të shpërndara në rubrika të ndryshme.	Të krijohet një sistem i monitorimit të performances së procesit të monitorimit, përfshirë edhe metodologjitë dhe mjetet indikative.
Adresimi i komenteve, mbetet në nivel të ulët, përgjithësisht komunat hartojnë procesverbale, e në rastet kur hartojnë raporte, nuk adresojnë në të gjitha rastet komentet.	Të rritet niveli i monitorimit nga dega ekzekutive dhe legjislative për nivelin e konsultimit publik.
Përfshirja në fazat e hershme në proceset e konsultimit, mbetet e ulët. Në disa raste raportohet se kanë hartuar disa regjistra me grupet e interesit, e kryesisht kjo ndodhë në dëgjimet buxhetore.	Të krijohen metodologji, të autorizohen grupe pune për të mbledhur të dhëna në krijimin e regjistrave të grupeve të interesit.
Përfshirja e palëve të interesuara në grupet punuese;	Të krijohet një bazë e të dhënave sipas profileve të OShC-ve dhe profesionistëve për përfshirje në grupet punuese të hartimit të akteve komunale

## Të ndërthurura

Konkluzione	Rekomandime
<p>Raporti i vlerësimit të transparencës në komuna (janar-qershor) 2022, te përmbledhja ekzekutive thekson se: ‘qasja në ueb faqe zyrtare të komunave nuk është e mundshme gjatë gjithë kohës dhe krijon vështirësi në hapjen e dokumenteve, saktësinë e të dhënave dhe ka raste kur ueb faqet zyrtare të komunave dalin nga sistemi dhe nuk lejojnë marrjen e informacioneve për dokumente, që duhet të jenë të arritshme për publikun, brenda afateve kohore.’</p> <p>Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave, kemi si në vijim: 21 komuna ose 55% e tyre nuk kanë publikuar numrin e raporteve për konsultime publike, ndërsa 17 komuna ose 45% e tyre kanë publikuar raportet për konsultime publike për vitin 2022.</p>	<p>Komunat duhet t’iu përmbahen Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, që ueb faqet e institucioneve publike duhet të kenë të zhvilluar dhe të funksionalizuar modulën e kërkimit, i cili duhet të jetë i vendosur në ballinë. Moduli i kërkimit duhet të optimalizohet ashtu që dokumentet, informatat në ueb faqe të gjenden shpejt dhe lehtë.</p>

<p>Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave nga raporti për vlerësimin e transparencës në komuna (janar-dhjetor) 2022, vetëm 19 komuna ose 50% e tyre kanë publikuar planifikimin e konsultimeve publike<sup>34</sup>.</p> <p>Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave, kemi si në vijim; 21 komuna ose 55% e tyre nuk kanë publikuar numrin e raporteve për konsultime publike, ndërsa 17 ose 45%, e komunave kanë publikuar raportet për konsultime publike për vitin 2022.</p>	<p>Komunat të cilat nuk e kanë plotësuar këtë kriter ligjor, rekomandohen të shtojnë fokusin në publikimin e planeve të konsultimeve publike. Komunat duhet të dorëzojnë raportin e konsultimeve publike, së bashku me projekt aktin e propozuar për aprovim në Kuvendin Komunal.</p>
<p>Bazuar në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik, komuna siguron publikimin e projekt propozimeve në ueb faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e konsultimeve publike në nivel qendror. Projekt propozimet, të cilat u nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.</p>	<p>Projekt propozimet të cilat u nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.</p>
<p>Pra, sipas të dhënave nga monitorimi i faqeve zyrtare të komunave të Republikës së Kosovës, nga 38 komuna në total, 32 komuna ose 85% e tyre kanë publikuar njoftime për takime publike me qytetarë, ndërsa 6 komuna ose 15% e tyre nuk kanë publikuar asnjë njoftim për takime me qytetarë, gjatë kësaj periudhe janar-dhjetor 2022.</p>	
<p>Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave, kemi si në vijim: 21 komuna ose 55% e tyre nuk kanë publikuar numrin e raporteve për konsultime publike, ndërsa 17 komuna ose 45%, e tyre kanë publikuar raportet për konsultime publike për vitin 2022.</p>	<p>Komunat duhet të dorëzojnë raportin e konsultimeve publike, së bashku me projekt aktin e propozuar për aprovim në Kuvendin Komunal.</p> <p>Projekt-propozimet, të cilat u nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.</p>
<p>Komunat duhet të fillojnë me përgatitjen e raporteve kthyese pas përmbylljes së konsultimeve publike, në mënyrë që qytetarët dhe grupet e interesit të informohen për çështjet, të cilat i kanë adresuar dhe arsyet për mospranimin e propozimeve.</p>	<p>Komunat duhet të fillojnë me përgatitjen e raporteve kthyese pas përmbylljes së konsultimeve publike, në mënyrë që qytetarët dhe grupet e interesit të informohen për çështjet, të cilat i kanë adresuar dhe arsyet për mospranimin e propozimeve.</p>

<sup>34</sup> <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F04%2FRAPORTI-PER-VLERESIMIN-E-TRANSPARENCES-03.04.2023- Shq -LEKTORUAR.docx&wdOrigin=BROWSELINK>

<p>Projekt propozimet të cilat u nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.</p> <p>Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave, kemi si në vijim: 19 komuna ose 50% e tyre kanë publikuar planifikimin e konsultimeve publike, ndërsa 19 komuna ose 15% e tyre e kanë publikuar planifikimin e konsultimeve publike në komuna.</p>	<p>Rekomandimet tjera për komuna, janë publikimi i projekt propozimeve (projekt akteve) të publikuara në faqen zyrtare të komunës, për të cilat kërkohet konsultimi i qytetarëve dhe t'i vendosin te linku i konsultimeve publike dhe jo te debatet publike, gjë që krijon edhe vështirësi për të dhëna të sakta.</p>
<p>Udhëzimi administrativ Nr. 06/2018 për Standarde Minimale të Konsultimit Publik, obligon autoritetet lokale që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovojë transparencën komunale, si dhe të ndikojë në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm.</p>	<p>Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.</p>

## Specifike

Konkluzione	Rekomandime
<p>Nga raportimet vjetore, del se 71% e komunave kanë krijuar rubrikën e veçantë në ueb faqet komunale, ndërkaq 29% e komunave nuk kanë rubrikë të veçantë.</p> <p>Lidhur me publikimin e projekt propozimit në ueb faqet komunale dhe platformën e-konsultime, 84% e komunave kanë publikuar projekt-propozimin në ueb faqet komunale, ndërkaq 64% e tyre kanë bërë publikimin në e-konsultime.</p>	<p>Të ndahen modulet/segmentet e konsultimit sipas njësive të konsultimit.</p> <p>Të strukturohen të dhënat sipas rendit logjik në një seksion të veçantë (thirrja, procesi i konsultimit, procesverbali, raporti me komente).</p>
<p>44% e komunave kanë përgatitur planet e konsultimeve, 32% e komunave e kanë përfshirë planin e konsultimeve në planin e punës, 32% e komunave kanë përgatitur plan të veçantë për të gjitha propozimet për konsultime publike. Vetëm 32% kanë hartuar formularët shpjegues dhe dokumentacionin përcjellës;</p>	<p>Të krijohet një plan i integruar i konsultimeve dhe detyrave.</p> <p>Të krijohet harta e proceseve të konsultimeve dhe kalendari.</p> <p>Të krijohet format standard i procesit të konsultimit dhe raportimit.</p> <p>Të hartohen dhe bashkëngjiten formularët shpjegues dokumentit të konsultimit.</p>

<p>Për pyetjen se a është bërë shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve në platformën e qeverisë për konsultime publike, 66% e komunave të monitoruara kanë përmbushur këtë obligim. Shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, në ueb faqet e komunave është zbatuar në 93% të komunave. Përqindje e ulët është reflektuar në paraqitjen e memorandumëve shpjeguese në ftesën për takimin publik, ku vetëm 22% e komunave kanë zbatuar këtë kriter, ndërsa 78% e komunave nuk kanë paraqitur memorandumet shpjeguese në thirrje publike.</p>	<p>Të përdoret tabelë nga doracaku i MAPL-së për konsultimet publike (aneksi 1).<sup>35</sup> Të nxirren të dhëna nga formularët shpjegues si mjete për përmirësim të proceseve.  Të hartohen ftesa/thirrje sipas doracakut si dhe të ofrohen informacionet e memorandumit shpjegues (referuar aneksit 2 të doracakut të MAPL-së)<sup>36</sup>.</p>
<p>54% e komunave kanë përgatitur raportin për rezultatet e konsultimit publik nga zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit; 51% e komunave kanë përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku; 37% e komunave kanë shqyrtuar komentet (pranuar/refuzuar) nga grupi punues; 50% e komunave kanë publikuar raportin brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendrike që nga përfundimi i afatit për komente); si dhe 18% e komunave kanë paraqitur raportin e konsultimit publik në Kuvendin e Komunës para aprovimit të projekt propozimit.</p>	<p>Të krijohen forma standarde të publikimit të raporteve të konsultimit. Të hartohen raportet me komente, duke përfshirë edhe statusin (pranuar/refuzuar) si dhe shpjegimin. Të përfshihen në kthimin e komenteve edhe kërkesat e protokolluara në zyrat pritëse për qytetarët, në veçanti për proceset buxhetore.</p>
<p>Nga 5 indikatorë del se nga 34 komunat e monitoruara, 76% prej tyre kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për konsultim publik; 32% kanë hartuar formularët shpjegues dhe dokumentacionin përcjellës; 32% kanë përcjellë afatet kohore; 41% kanë përgatitur raportet vjetore dhe raportuar tek kryetari dhe 79% kanë raportuar te Ministria përgjegjëse për monitorim.</p>	<p>Të shtohet monitorimi nga kryetarët e komunave për aktet që nuk kanë kaluar procesin e konsultimit. Të rriten mbikëqyrja e anëtarëve të Kuvendeve Komunale, për aktet që propozohen për miratim pa shtojcat e konsultimit publik.</p>
<p>Vetëm 6.25% e komunave kanë zhvilluar konsultime në fazat e hershme, ndërsa 93.75% e tyre nuk e kanë përmbushur këtë fazë.</p>	<p>Të nisë një proces i evidentimit të grupeve të interesit për proceset e konsultimeve publike. Të hartohen qasje të veçanta për konsultimet në fazat e hershme për grupet e afektuar nga akti komunal.</p>
<p>Nga 16 komunat që kanë raportuar vetëm 31% e tyre kanë krijuar baza të të dhënave (Excel lista) dhe asnjë nuk ka hapur shpallje për identifikimin e palëve të interesuara. Po ashtu, në asnjë komunë nuk</p>	<p>Të krijohen lista dhe baza e të dhënave për organizatat dhe profesionistët që mund të përfshihen në grupet punuese.</p>

<sup>35</sup> [FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet-2.pdf \(rks-gov.net\)](#)

<sup>36</sup> [FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet-2.pdf \(rks-gov.net\)](#)

është raportuar se ka pasur propozime nga grupet e jashtme punuese, iniciativat qytetare apo komitetet konsultative <sup>37</sup> .	Të krijohen platforma komunale për përfshirjen e pro-aktive të profesionistëve në politikat lokale.
---	---

---

<sup>37</sup> Referuar nenit 70 iniciativat qytetare dhe nenit 73 komitetet konsultative të ligjit për vetëqeverisje lokale



**KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE**

**Kosovo Local Government Institute**  
**Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000**  
**Prishtinë, Republic of Kosovo**  
**Tel: +381 (0) 38 522 000**  
**Mobile: +383 (0) 44 253 835**  
**E-mail: [info@klgi-ks.com](mailto:info@klgi-ks.com) | web: [www.klgi-ks.com](http://www.klgi-ks.com)**